




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e nëntë (IX) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 30.7.2014 me këtë:

R E N D P U N E

- 1** Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1 Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2014
 - 2.2 Propozim vendimi mbi qasjen e revidimit të vendimit për miratimin e zgjidhjes urbanistike të kompleksit, Shkollat e Mesme në Gjilan
 - 2.3 Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm: “Lagja e Spitalit”, në Gjilan
 - 2.4 Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm: “Qendra -3”, në Gjilan
 - 2.5 Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm: “Zabeli-1”, në Gjilan

3 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.00

Në punimet e seancës së nëntë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Përfaqësuesi i OSB-së, Basri Sejdiu

Përfaqësuesi për të Drejtat e Njeriut Fazli Abdullahu

Mediet

Seancën e nëntë e hapi dhe udhëhoqi kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku – Rexhepi e cila fillimisht e përshëndeti kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, nënkryetarin Rexhep Kadriu, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët i monitorojnë punimet e kësaj seance, por njëkohësisht të gjithëve ia uron edhe festën e Fitër Bajramit.

Në vijim të punimeve të seancës, kryesuesja kërkon që të bëhet verifikimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës janë të pranishëm 33 anëtarë, kurse mundojnë 2.:

Në vijim të seancës kryesuesja thekson se materialin e kanë marrë të gjithë anëtarët e Kuvendit, prandaj kërkon që të deklarohen anëtarët e Kuvendit a pajtohen me këtë rend të punës, apo ka ndonjë vërejtje?

Avdyl Aliu- kërkesa ime për rendin e punës është që pika 2.3, 2.4 dhe 2.5 për nga përmbajtja janë pika të ngjashme, prandaj për hir të racionalizmit të kohës kërkoj që të debatohen si një pikë ose të aprovohen në paketë.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- propozimi i z. Aliu është që pika 2.3, 2.4 dhe 2.5 të shqyrtohen si një pikë, prandaj kërkoj që të deklaroheni se kush është për këtë propozim?

Aprovohet rendi i punës sipas propozimit të z. Aliu me 20 vota për, 4 kundër, kurse të tjerët abstenuan

Sahit Abazi- unë e kam një kërkesë të cilën e posedon edhe kryetari i Komunës në të cilën kërkesë bëhet fjalës për Shqotën e Invalidëve të Punës, prandaj këtë kërkesë e kam për obligim që ta paraqes për debat në seancë në cilësinë e anëtarit të Kuvendit ose në këtë seancë ose në ndonjë seancë tjetër! Në këtë kërkesë bëhet fjalë për dy shoqata pensionale dhe njëra prej tyre pretendon se ka më shumë anëtarë, por nuk kanë hapësirë për aktivitetet, prandaj pyetja duhet të jetë për kryetarin e Komunës se cila do të jetë zgjidhja për këtë shoqatë?

Riad Rashiti- unë e kam një propozim për rend të ditës dhe kërkoj që të shtohet edhe pika f; Transparenca e qeverisjes së Komunës së Gjilanit. Është e nevojshme që të bëhet një debat në KK, sepse ne e kemi shprehur shqetësimin tonë që nga fillimi i kësaj qeverisje, sepse kemi bërë me një mos transparencë në punën e të gjitha institucioneve komunale. Ky vlerësim nuk është vetëm i yni, por është edhe i dy OJQ-ve të cilat e kanë monitoruar punën e institucioneve tona, por është edhe shqetësimi i yni personal, sepse deri më tash i kam drejtuar 37 kërkesa me shkrim me të cilat iu kam drejtuar institucioneve komunale dhe prej 37 kërkesave, vetëm për 6 kam marrë përgjigje dhe ato përgjigje janë vetëm nga Sekretaria e Kuvendit të cilën e falënderoj për një bashkëpunim të mirë, një përgjigje e kam marrë nga Drejtoria për Financa, një nga Zyra e Prokurimit, kurse përgjigje të tjera nuk kam marrë. Vetëm Zyrës së Kryetarit të Komunës ia kam drejtuar 8 kërkesa dhe asnjë përgjigje nuk e kam marrë.

Nuk e di pse nuk është kthyer asnjë përgjigje? A është çështje e kohës, sepse kryetari

ndoshta nuk ka kohë, apo është injorim i anëtarëve të KK-së.

Po ashtu edhe kryesueses dy herë i kam dërguar një kërkesë me shkrim dhe nuk kam marrë përgjigje edhe pse kanë kaluar plotë 4 muaj!?

Për këtë arsyeje propozoj që në ren dite të jetë edhe një pikë: Transparenca në Komunën e Gjilanit?

Në emër të grupit kuvendar të PDK-së e shfrytëzoj rastin ta bëjë një kërkesë kryetarit të Komunës dhe ajo kërkesë ka të bëjë me lirin e menjëhershëm të hapësirave komunale të cilat janë uzurpuar me dijen dhe lejen e institucioneve komunale për parkingjet e Komunës së Gjilanit. Ne e dimë dhe ju e dini të gjithë se ende nuk është nënshkruar një kontratë për shfrytëzimin e pronës publike që ka të bëjë ka me ankandin publik, prandaj kërkoj që kryetari i Komunës ta shfrytëzojë autoritetin për ta liruar ose për ta ndaluar vendimin për këto hapësira të cilat janë uzurpuar. Unë kërkoj që të lirohen hapësirat e Komunës së Gjilanit të cilat janë uzurpuar nga kompania e cila nuk ka asnjë kontratë me KK të Gjilanit!

Mandej i kam dy pyetje për kryetarin e Komunës: a ka në Komunë të Gjilanit të punësuar të cilët paguhen privatisht nga zyrtarët e lartë të Komunës së Gjilanit?

Në çfarë forme i keni angazhuar punëtorët të cilët po bëjnë sigurimin fizik në objekte shkollore dhe shëndetësore ?

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- sa i përket transparcës si pikë e veçantë për ta fut në rend të punës, sot nuk është paraparë, por ju mund ta bëni kërkesën me shkrim dhe ajo kërkesë analizohet dhe nëse ka nevojë e fusim në rend të ditës.

Riad Rashiti-kërkesën me shkrim e kam dërguar në afat ligjor, 7 ditë para mbajtjes së seancës dhe kërkoj që ta propozoni për rend të punës. Transparenca në Komunën e Gjilanit?

Valentinë Bunjaku Rexhepi- kush është për atë që të futet në rend të punës pikën të cilin e propozoi z. Rashtiti: Transparenca në Komunën e Gjilanit?

Nuk aprovohet propozimi i z. Rashti, sepse për të hyrë në rend pune; Transparenca në Komunën e Gjilanit votuan 7, anëtarë të Kuvendit, kurse 21 ishin kundër.

Bujar Nevzadi-unë i kam disa kërkesa dhe disa pyetje e të cilat më janë grumbulluar në një periudhë 7 mujore, por nëse kryetari i Komunës ka kohë për të qëndruar në sallë deri në fund të seancës unë këto pyetje i lë për pikën : nën të ndryshme, nëse nuk ka kohë unë po i bëj tash!

Valentinë Rexhepi Bunjaku- propozimi i z. Nevzadi të mbetet nën të ndryshme.

Kush është për aprovim të rendit të punës?

Aprovohet rendi i punës me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, 2 ishin kundër, kurse të tjerët abstenuan.

Aprovimi i procesverbalit së seancës së kaluar

Nuk pati vërejtje në procesverbal i cili u miratua me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

2.1- Raporti financiar për periudhën-janar-qershor 2014

Lidhur me këtë pikë kryesuesja fjalën ia bartë drejtorit për Buxhet dhe Financa.

Sali Kçiku- unë në pika të trasha do ta bëj prezantimin e raportit financiar janar- qershor 2014. Edhe pse Komuna e Gjilanit, gjegjësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa është ballafaquar me shumë borxhe nga qeverisja e kaluar dhe në shkurtime buxhetore prej 15 % për mallra dhe shërbime nga Qeveria e Kosovës për rritjen e pagave ne kemi arritur që në një periudhën gjashtë mujore ta kryejmë një pjesë të borxheve të vitit 2013 dhe kemi arritur suksese në kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve me investime të mëdha në infrastrukturë, kursime të gjitha shpenzimeve operative, ku mesatarja bie 70-80% dhe kemi zvogëlime të shpenzimeve në krahasim me periudhën e kaluar, por dhe e kemi bërë një menaxhim të parasë publike.

Buxheti për këtë vit ka qenë mbi 20 milion e 125 mijë, € i cili buxhet është ndarë për Administratë Komunale, buxhet për Shëndetësi dhe buxhet për Arsim.

Në vijim të fjalës së tij z. Kçiku dha sqarime detale lidhur me këtë raport, të cilin raport anëtarët e Kuvendit e kanë të kompletuar në material të seancës.

Riad Rashitit- në emër të grupit kuvendar të PDK-së po i jap mendimet tona sa i përket raportit 6 mujor financiar. Ne kemi pasur këtë raport, por gjatë fjalës së drejtorit përsëri na u dhanë deklarata të pabazuara e të cilat i paraqet me përqindje. Absolutisht nuk qëndrojnë dhe absolutisht nuk qëndrojnë këto zvogëlime të shpenzimeve dhe absolutisht nuk qëndrojnë shumë gjëra të cilat u thanë!

Ne si grupo e konsiderojmë dhe e vlerësojmë se ky raport nuk është i kompletuar ashtu siç duhet për ta prezantuar sot në Kuvend. Kanë kaluar gjashtë muaj dhe nuk keni qenë në gjendje për të na i sqaruar disa gjëra e njëra prej tyre është edhe me borxhet e Komunës. Ende nuk na e keni sjell një informatë të detajuar, keni thënë herë nëntë milion, herë gjashtë, herë katër, por në seancën e kaluar gjatë rishikimit të buxhetit u zyrtarizua që kanë qenë 4.1 milion, por me bartje të mjeteve u pa se janë 3.7 milion borxh. Në fund u panë gjërat dhe u bindët, se nuk po iu besohet fjalëve që po i thoni dhe po dëshironi ju! Ju pandërprerë e thoni zero shpenzime, por në asnjë kod buxhetor nuk keni zero shpenzime. Mandej në këtë raport financiar ka shumë gabime teknike e që ka të bëjë me mbledhje të shifrave. Tjetër diçka shkruhet në raport, por diçka tjetër shihet në shifra e të cilat do t' i sqaroj se ku janë ato gabime në mbledhje të këtyre shpenzimeve.

Sa i përket të hyrave vetanke ky raport paraqet në jo efikasitet të drejtorive komunale.

Në shikim të parë drejtori e tha se kemi rritje për 6.81% e që unë mendoj se ai krahasim nuk është real, sepse ai është munduar për ta paraqitur sa më pozitiv raportin.

Te të hyrat nga Administrata e Përgjithshme kemi zotim të hyrat mbi 11 mijë € më pak të hyra se sa planifikimi. Të hyrat nga qiraja janë më pak mbi 24 mijë €, të hyrat nga biznesi i keni mbi 60 mijë, të hyrat nga lejet e ndërtimit i keni më pak mbi 58 mijë €.

Të gjitha këto që i përmenda janë më pak se sa planifikimi. Nga Shërbimet Publike i keni mbi 1 mijë 900 €, më pak, nga Inspeksioni mbi 9 mijë €, nga tatimi në pronë i keni më pak mbi 106 mijë €, nga Drejtoria e Bujqësisë i keni 10 mijë € më pak, të hyrat nga shëndetësia keni mbi 22 mijë € më pak, të hyra nga shërbimi ekonomik i keni mbi 67 mijë € më pak. Të gjitha këto kur llogariten nga Drejtoria për Financa keni të hyra më pak për 371 mijë €. Këto janë dëshmi të cilat nuk mund t' i mohoni, sepse janë të

bazuara në Raport financiar.

Ju keni të hyra që ndoshta e kanë rrit nivelin e totalit të të hyrave dhe me atë që ka të bëjë me gjobat në trafik dhe me gjobat e gjykatave e të cila të hyra nuk janë nga angazhimi i juaj dhe nga institucionet komunale, sepse vetëm në këto dy kode i keni 336 mijë € të hyra.

Në raportin përmbledhës të shpenzimeve shihet se kemi rritje në këtë kategori në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar mbi 1 milion e 266 mijë €. Në vitin e kaluar në të gjitha kodet janë shpenzuar 8 milion 585 mijë €, ndërsa në vitin 2014 janë shpenzuar 9 milion e 800 e 1 mijë €. Kuptohet se rritja më e madhe e këtyre shpenzimeve është në paga, por kemi rritje të shpenzimeve edhe në kode të tjera. Nëpër disa drejtori komunale, kemi rritje të shpenzimeve për mbi 66 mijë €, për mallra dhe shërbime keni shpenzime më shumë për 113 mijë €. Nëpër disa kategori të tjera po ashtu ka rritje të shpenzimeve dhe në asnjë mënyrë nuk qëndron ajo që thotë drejtori se ka zvogëlim të shpenzimeve 70-80 %. Mirëpo marrë në përgjithësi keni rritje enorme të shpenzimeve në krahasim me vitin 2013. Keni po ashtu projekte më pak të investuara kapitale në krahasim me vitin e kaluar në vlerë prej mbi 85 mijë €.

Sa i përket shpenzimeve jashtë vendit 6mijë e 667 €, janë shpenzuar nga kryetari i Komunës për këta 6 muaj vetëm për mëditje jashtë vendit. Janë një pjesë të vitit të kaluar që janë kryer, por shpenzime të këtij vitit janë mbi 2 mijë e 100 € për mëditje jashtë vendit dhe akomodim. Gjatë të tërë kohës është thënë se kryetari i Komunës po bënë vizita jashtë vendit, por jo me shpenzime të Komunës, mirëpo tash po del diçka tjetër. Shpenzime jashtë vendit janë paraqitur 4 mijë e 200 € dhe nuk dihet as për cilët zyrtarë dhe për çfarë qëllimi është bërë udhëtimi jashtë vendit? Kemi shpenzime mbi 900 euro me karakter studimor në Shqipëri me 15 maj dhe nuk dihet tema dhe çfarë rezultati është dhënë? Akomodim i personelit të Administratës në Durrës, por as për këtë nuk e dimë as qëllimin as numrin e zyrtarëve. Në total janë bërë 7 mijë €, për vizita studimore, kurse ne nuk jemi njoftuar fare për këto “vizita studimore”.

Keni shpenzuar 3600€ për telefoni fikse, por keni nënshkruar një kontratë 34 mijë € për Telecomin e Kosovës. Keni theksuar disa herë se keni zero shpenzime, por nuk qëndron ajo, sepse nuk ka mundësi Komuna e Gjilanit të funksionojë me zero shpenzime.

A është zvogëlim i shpenzimit për shërbime të varrimit për të cilin këtë vit i keni paguar 172 mijë €. Këtë nuk mund ta quani zvogëlim të shpenzimeve, sepse njerëzit nuk kanë vdek më pak për hir të juaj!

Në vijim të fjalës z. tij z. Rashti dha edhe shumë shembuj të tillë duke bërë krahasime këtë vit me atë të vitit të kaluar. Në përgjithësi për dreka zyrtare ushqim dhe pije nga buxheti i Komunës së Gjilanit janë shpenzuar mbi 95 mijë €. Nga këto mjete disa kanë qenë borxhe, por vetëm për këtë vit janë paguar vetëm për dreka zyrtare mbi 34 mijë €. Furnizim për ushqim dhe pije janë shpenzuar mbi 60 mijë €, dhe kur t' i pjesëtojmë me ditë të punës për ditë të punës del se janë shpenzuar 760 €, për çdo ditë të punës dhe fare nuk qëndron ajo që keni zero shpenzime.

Te subvencionet unë kërkoj përgjigje për një rast ku është shkelur rregullorja për një rast të një shtëpie, kur janë ndarë njëherë 5 mijë €, por edhe njëherë tjetër të njëjtit person 2 mijë e 967 €. Këto mjete janë ndarë pa vendim të KK-së dhe pa vendim të KPF-së dhe kjo është plotësisht në kundërshtim me Rregulloren, sepse kryetari i Komunës nuk ka të drejtë të ndajë shuma kaq të mëdha për subvencione? Te subvencionet e Kulturës dhe Rinisë janë paraqitur mbi 107 mijë € në tabelë, por realisht kur të mbledhen shifrat janë mbi 108 mijë €, do të thotë 500 € më shumë. Te subvencionet e kryetarit janë paraqitur mbi 18 mijë e 700 €, kurse realisht janë 1 mijë € më shumë. Për vizitë studimore në

Preshevë janë harxhuar 1mijë e 400, por nuk dihet çfarë vizite është kjo dhe kush ka shuar? Mbi 3 mijë e 300 €, iu janë ndarë Qendrës Kulturore “Laboratriumi” Mesatarisht klubeve të mëdha iu janë ndarë nga 607 € për këtë gjashtë mujor, kurse kësaj qendre iu kanë ndarë 3 mijë e 300 € për këtë gjashtë mujor.

Te pajisjet tjera janë mbi 9 mijë €, nuk dihet se për çfarë pajisje, furnizimi për veshmbathje, por e dimë që e kemi bërë një kontratë mbi 4 mijë 800 €, por ne jemi veshur me para tona, kurse këtu 4 mijë e 800 € i keni shfrytëzuar.

Ne konstatojmë se gjatë kësaj kohe kemi pasur rënie të nivelit të inkasimit, kemi rritje të shpenzimeve në përgjithësi, kemi zvogëlim të investimeve kapitale dhe kemi shumë shkelje të shumta ligjore dhe procedurale, sidomos nga Zyra e Prokurimit.

Kemi zvogëlim të subvencioneve në bujqësi, kemi stagnim të plotë të projekteve nga Drejtoria e zhvillimit Ekonomik. Me një fjalë kemi ç’orientim total të kësaj qeverisje sa i përket zhvillimit të infrastrukturës, prandaj i preferoj kryetarit të Komunës që më tepër të merret me qeverisjen e Komunës dhe mos të merret me kufijtë e Kosovës, sepse kjo është punë e OKB-së, kurse qytetarët presin më shumë nga kryetari dhe kjo qeverisje.

Zijadin Maliqi- unë e dëgjova drejtorin e Drejtorisë për Financa, por edhe opozitën, mirëpo unë bukur mirë jam munduar ta bëj një analizë të këtij raporti. Unë mendoj se ky raport financiar është i përgatitur mirë dhe është raport zyrtar dhe të dhënat duhet të jenë shumë reale. Të hyrat po shihet se janë realizuar afër 45% nga të hyrat e përgjithshme të planifikuara për vitin 2014. mendoj se ka vend ende për t’u përmirësuar kjo, por nuk është keq, sepse ne e dimë se të hyrat janë sipas periudhave të caktuara dhe disa realizohen më pak e disa më shumë. U tha edhe nga drejtori se të hyrat në krahasim me vitin e kaluar janë afër 7% më të mëdha, por u përmend nga përfaqësuesi i opozitës se në disa kategori ka ngecje, por nuk u tha se në disa kategori ka rritje mjaft të mirë! Ka punë ende për drejtorët e drejtorive përkatëse, sepse kjo nuk është punë vetëm e Drejtorisë për Financave, sepse ka të hyra nga qiraja, nga biznesi, leje të ndërtimit Inspeksioni dhe tatimi në pronë. Mirëpo unë besoj se gjatë korrikut dhe gushtit do të tejkalohet ajo që është planifikuar, sepse është periudha që bashkatdhetarët vijnë dhe i kryejnë obligimet e veta. Marrë në përgjegjësi unë personalisht jam i kënaqur me të hyrat që janë realizuar, por ka vend për përmirësim edhe të mëtejme. Sa i përket shpenzimeve, nëse merren për këtë 6 mujor në tërësi duket se janë më të mëdha se sa në gjashtë mujorin e vitit të kaluar, por këtu ka ndikuar rritja e pagave prej 25% dhe ato janë rreth 1 milion e 500 mijë € më të mëdha se sa vitin e kaluar. Shihet në këtë drejtim është punuar mirë, janë shpenzuar kryesisht grandet nga Qeveria e Kosovës, kurse më tepër janë lënë të hyrat vetanake e që për mua kjo është një punë shumë e mirë, sepse mjetet nga grandet janë shpenzuar për projete kapitale, kurse ato të zotuarat do të shpenzohen në periudhën e ardhshme. Shpenzimet janë 485 nga shpenzimet e planifikuara për vitin 2014.

Sa u përket shpenzimeve sipas kodeve buxhetore unë i kam nxjerr dhe diku rreth 95 % të kodeve buxhetore kemi zvogëlim të shpenzimeve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga kjo shihet se ka qenë një menaxhim i mirë i financave dhe është mundësua që për këtë periudhë të paguhen mbi 1 milion e 600 mijë € borxhe të mbetura nga vitet e kaluara. Nëse vazhdon në këtë mënyrë unë besoj se do të ofrohet bukur mirë pagesa e borxheve të cilat ekzistojnë.

Sa i përket investimeve kapitale në bazë të pagesave shihet se janë më të vogla në këtë periudhë, por janë procedurat e prokurimit të cilat kërkojnë kohë. Gjithashtu edhe zotimi i mjeteve tregon që gjatë periudhës së ardhshme do të bëhen pagesat dhe në raportet e ardhshme do të shihet se janë bërë shpenzime shumë më të mëdha edhe në investimet kapitale ku dot ë shihen punët e Komunës.

Selami Xhemajli- në emër të grupit të AAK i japim mbështetje këtij raportit financiar për 6 mujorin e parë të këtij vit, sepse është një raport shumë mirë i përgatitur edhe teknikisht edhe profesionalisht. Nga ky raport shihet se kemi të bëjmë me një ndryshim të gjendjes në menaxhimin e buxhetit të Komunës, sepse është një raport i detajuar sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve dhe unë plotësisht e mbështes, sepse vërehet një menaxhim i mirë me buxhet të Komunës dhe vërehet një ulje e shpenzimeve. Unë mbështes edhe paraqitjen e drejtorit, por edhe të kolegut Zijadin.

Bujar Nevzadi – sa i përket raportit të faqja numër 2 të shpenzimeve kapitale planifikimi është 4 milion e 57 mijë €, kurse janë paraqitur shpenzime 1 milion e 500 mijë €.

Nga kjo shihet se kanë kaluar 7 muaj të viti e që është desh të bëhet punë, prandaj unë pres se kur do t' i shpenzoni këto mjete? Ju këtë po e quani menaxhim të mirë.

Te faqja numër 6 planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake, nuk ka angazhim për realizim të hyrave dhe me 40%, mendoj se është dështim në inkasim të të hyrave sidomos në tatimin në pronë. Kjo na e kujton atë periudhë të vitit 2007 kur ne kemi ardhur në pushtet, qytetarët po i futini në obligime, kamata e ndëshkime dhe po bëni apele në mjete të informimit dhe mendoj se në këtë mënyrë nuk inkasohen mjetet.

Në vitin 2007 kur kemi ardhur në pushtet i kemi gjet borxh 5 milion €, nuk i keni respektuar vendimet e kushtëzimeve. Ju e keni pasur qëllimin për t' i fituar zgjedhjet të cilat edhe i keni fituar, por tash grumbulloni mjete dhe punoni, ne nuk kemi asgjë kundër. Te faqja numër 7 pagesat e investimeve janë bërë vetëm nga grandit, por ku janë pagesat nga të hyrat vetanake? Te faqja numër 8 shpenzimet nga të hyrat vetanake, nuk është bërë asnjë investim nga të hyra tjetër dhe të gjitha kanë shkuar në subvencione. Te faqja nr. 10 të gjitha tabelat nuk janë të komentuar dhe është hera e parë që marrim raport financiar pa komente. Vazhdimisht keni thënë se do të keni dhurues, po vijnë dhuruesit, kurse në tabela i keni vetëm 8 mijë € nga dhuruesit e jashtëm. Te faqja nr. 11 shpenzimet e gjashtëmujorit, por këtu ka qenë desh edhe planifikimi edhe shpenzimet të paraqiten për çdo njësi buxhetore. Te faqja e fundit kam pyetje dhe kërkesë për sqarim: “sa obligime i ka Komuna pa paguar për vitin 2013?”, “A ka obligime të pashlyera”, “Pse nuk i keni paraqit në tabelë”? Mandej kërkojmë që në seancën e ardhme të sillet lista e obligimeve të papaguara dhe operatorët të specifikoni për obligime dhe listën e atyre të cilëve nuk iu kanë kryer obligimet”? Kërkoj që këto përgjigje t' i sillini në seancën e radhës ose të më dërgohen në adresë elektronike?

Avdyl Aliu- po vërehet dikush thumbit dikush potkoit, dikush në një mënyrë, dikush në mënyrë tjetër, por është e çuditshme një parë letra i kemi përpara. E kemi lodhur qytetarin e Gjilanit dhe e kemi vërë në një dyshim shumë të madh edhe pse i kemi një parë letra në tavolinë. Këto letra që i kemi përpara i bëjmë karikatura dhe i shtrembërojmë para qytetarëve, por për ta heq këtë dyshim duhen fakte e të cilat fakte të gjithë i kemi përpara. Unë i kam bërë krahasimet dhe shifrat që i tha drejtori dhe kolegët dhe që janë në raporte të vitit 2012. 2013, 2014 e qartësojnë shumë mirë këtë dyshim. Këto shifra dike e qesin mirë, kurse dike e qesin të mjerë!

Rekapitullimin e shpenzimeve sipas kodeve ekonomike drejtori e ka bërë shumë mirë tabelën dhe i ka ndarë shumë shpenzimet e krijuara të vitit 2014, por edhe ato që i kemi paguar në vitin 2014 e që janë borxhe të vitit 2013. Unë e kam shtuar edhe një dhe për qartësim e kam marrë edhe gjashtë mujorin e vitit 2012. Shkurtimisht po i paraqes disa prej tyre. Kodi 13110 –shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, 2014 janë mbi 68 mijë €, në vitin 2012 janë 112 mijë €, më 2013 janë 220 mijë. Shikoni krahasimet 111 mijë, 220

dhe 61 mijë! Kjo nuk do shumë koment!

Është tjetra shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, kodi 13140- Në vitin 2014 janë 180 €, më 2012 janë 29 mijë €, më 2013 janë 18 mijë €. Po pyes çka është ky dallim?

Shpenzimet tjera “Vala”, më 2014 janë shpenzuar 3 mijë e 600 €, më 2012 mbi 16 mijë €, 2013, 19 mijë €. Shikoni dallimet 16, mijë, 19 mijë dhe 3 mijë ! Kjo është shumë e qartë dhe po dihen shumë gjëra dhe këto gjëra dike e bëjnë të mjerë kur i sheh këto shifra kështu. Shërbime të ngjashme shëndetësore më 2014 është 418 €, më 2012 mbi 5 mijë e 600 €, kurse më 2013 është 14 mijë €. Shikoni krahasimet 400, mbi 5 mijë dhe 14 mijë. Për të mos marrë shumë kohë në fund po e them edhe totalin dhe del se shpenzimet sipas kodeve ekonomike për tri vitet e fundit janë: më 2012 është 10 milion e 272 mijë €, më 2013 është 10 milion e 175 mijë € dhe 2014 është 8 milion e 162 mijë €. Në bazë të kësaj 2 milion €, janë shpenzime më pak në vitin 2014 se dy vitet paraprake të qeverisjes së kaluar. Në fund po them se po t’ia besosh plakut për ta udhëheq katundin e vetë i cili nuk din për ta udhëheq shtëpinë e vetë, shumë shpejtë do ta bëjë edhe katundin si shtëpinë e vetë!

Bujar Nevzadi- nuk jam i interesuar të merrem me këto përralla të shefit të grupit të LDK-së. Unë po them shefit të grupit të LDK-së që ta lus zotin që të ketë përsëri tërmet në Gjilan. Tjetër ta merr katin e banesave të cilin e ka ndërtuar pa leje dhe ta rrënojë! Gjithashtu ballkonin ta rrënojë! Le t’i rregullon kanalizimin 50 familjeve të cilave ia ka bllokuar rrugën. Mos të na mbajë ligjërata neve ky njeri, por le t’iu mbajë juve të cilin e keni vërë në krye të grupit, njeriun i cili e pengon kanalizimin e 50 qytetarëve dhe gjërat e tjera të cilat ia përmenda.

Riad Rashiti- së pari më vjen mirë që u pajtuat edhe grupi kuvendar i LDK-së në këtë rast që kemi në total rritje të shpenzimeve, ky pranim i këtij fakti është një e mirë.

Diku kemi zvogëlim, diku kemi rritje, por me rëndësi është që kemi rritje të shpenzimeve. Gjithashtu ratë në dakord që kemi ulje të të hyrave vetanake, mandej u konstatua se kemi zvogëlim të investimeve kapitale edhe kjo është e mirë.

Te investimet kapitale për shëndetësi janë planifikuar 140 mijë €, por asnjëherë nuk janë bërë këto investime! Në fund e lus drejtorin që të përgjigje të pyetjen dhe të jep përgjigje për subvencionet e Komunës.

Arben Maliqi- unë fillimisht të gjithëve ia uroj festën e Fitër Bajramit, por e përshëndes edhe drejtorin për këtë raport gjashtë mujor i cili është një raport i mirë dhe mjaft i vlefshëm. Sa i përket raportit teknikisht unë që tri mandate jam anëtar i Kuvendit, por në këto raporte po na përcjellin gabimet. Ju lutem të kemi kujdes në gabime gjuhësore dhe fjalën gjithsejtë duhet ta dimë si shkruhet? Gjithmonë gabim po shkruhet, ky është një dokument me rëndësi dhe kjo fjalë diku me “a” diku me “ë” dhe kjo ndodh një kohë të gjatë. Këto janë gabime të vogla, teknike dhe gjuhësore, por kanë peshë!

Sa i përket investimeve kapitale kam një propozim konkretë te Posta e Vogël, “Dardania I” dhe “Dardania II”, sepse aty duhet urgjentisht të intervenohet, rregullohet trotuari në mënyrë që nxënësve t’iu mundësohet që të kalojnë sa më lehtë dhe të mos rrezikohen nga automjetet.

Patjetër duhet ta përmendim edhe inventarizimin e sallave të edukatës fizike dhe të kemi kujdes dhe t’i vëmë në prioritet. Shfrytëzoj rasatin që ta lus edhe kryetarin e Komunës që kilometrin e parë të fshatit Kosaq ta ketë parasysh, sepse kjo rrugë e ka vështirësuar jetën e banorëve të këtij fshati. Unë mendoj se ky fshat duhet të jetë në prioritet, sepse ka mbetur i vetmi fshat i cili nuk e ka rrugën e asfaltuar.

Mandej të mendohet në dobi të fëmijëve tanë dhe të mundësohet investimi në sportin shkollor dhe për këtë rast të jetë një kod i veçantë në mënyrë që fëmijëve t' i mundësohet për t' i zhvilluar aktivitetet e veta.

Zijadin Maliqi- gjashtë vite kam qenë anëtarë i KK-së në opozitë dhe jam marrë me çështje të buxhetit dhe raporteve financiare, por me plotë përgjegjësi po deklaroj se asnjëherë nuk kam thënë fjalë të pavërteta, por vetëm ato që janë të argumentuara në raport. Unë gjithmonë e kam llogaritur se raporti është shumë zyrtar, por edhe këtë e llogaris të tillë. Unë nuk thash se kemi zvogëlim të hyrave! Të hyrat janë të mira dhe 45% të të hyrave të përgjithshme dhe për herë të parë raporti është bërë si duhet.

Të hyrat janë realizuar 45%, kurse 5% nuk janë realizuar, kjo nuk qëndron. Buxheti kur planifikohet, planifikohet për tërë vitin dhe jo për tre muaj, nuk planifikohet për gjashtë muaj, por planifikohet për tërë vitin dhe thash është 45% dhe e thash se është mirë, por ka vend për përmirësime. Bëj apel te disa drejtorë të drejtorive që të angazhohen nëpër disa drejtori, por edhe ka periudha të caktuara kur ka të hyra më të vogla, por ka periudha kur të hyrat janë më të mëdha! Mirëpo në fund kur të nxirret raporti përfundimtar dihet se a është realizuar 99%, 95%, apo më pak?

Nga të hyrat ka rritje 7% më tepër se viti i kaluar dhe mendoj se nuk është keq!

Unë nëpër kode buxhetore nuk bëra sqarime detale dhe i kam parë edhe te mobilet dhe te kompjuterët, por diku rreth 95% të kodeve buxhetore ka zvogëlim të shpenzimeve, zvogëlime të dukshme nëpër kategori ku duhet të bëhen zvogëlime. Diku ndoshta edhe nuk duhet të bëhet zvogëlim të shpenzimeve, por ku ka mundësi ato janë bërë!

Unë i kam nxjerr edhe kodet te drekat zyrtare edhe atë edhe për ditë pune dhe kurrë nuk i kam futur ushqim dhe pije te drekat zyrtare, i kam ndarë ato, sepse ajo kategori është për çerdhe të fëmijëve, për konviktin e nxënësve dhe nuk guxon kjo kategori të hyjë te drekat zyrtare. Ajo është e ndarë, por nëse dëshiron dikush t' i bashkojë këto dy kode dhe ta rrit shumë ajo është diçka tjetër?

Rritja është bërë kur të merret pasqyra përfundimtare për shkak të rritjes së pagave prej 25% dhe asgjë nuk ka tjetër dhe të gjitha shpenzimet tjera janë më të vogla se më parë.

Bajram Hasani- ne ditën që e patëm rishikimin e buxhetit i dhamë vërejtje drejtorisë përkatëse që ta bëjë një analizë më të detajuar tekstuale dhe qenka marrë si serioze dhe këtu paska disa sqarime e cila punë është për ta përshëndetur. Qenka bërë një lloj përshkrim, por herëve të tjera kur të paraqiten mallrat dhe shërbimet duhet të të detajohen edhe këto edhe shpenzimet edhe të hyrat dhe të jetë një tekst pak më i gjerë. Sa i përket debateve po ta dëgjojë qytetari opozitën do të thotë jemi të mjerë kë e kemi votuar, por nëse e dëgjojmë pozitën thuhet se ka pasur përmirësime dhe zvogëlim të shpenzimeve! Mua më pëlqeu kolegu Zijadin kur e dha një sqarim me të cilin ishte shumë real. Mirëpo kërkojmë nga kryetari që të fillojë me zbatim të projekteve të punohet dhe të arsyetohemi te qytetarët me projekte konkrete.

Zijadin Maliqi- të gjitha raportet financiare janë në Drejtori të Financave dhe e lus drejtorin, sepse Bujari që disa herë po e potencon se ne ia keni lënë 5 milion € borxh?

Realiteti është se ne minimumi ne i kemi lënë më së paku 300 mijë € mjete se sa që ka pasur borxhe? Unë kërkoj nga drejtori t' i nxjerr të dhënat e sakta se sa mjete kanë mbetur për vitin 2008, kur ne kemi dal në opozitë?

Riad Rashiti- unë kërkoj fjalën, sepse është aluduar në emrin tim. Unë nuk flas të pavërteta dhe unë jam bazuar në dokumente zyrtare të cilat ju i keni siguruar dhe unë

nuk po flas në ajër. Unë po flas me dëshmi, për derisa Zjadini e tha se 95% i kemi kodet dhe zvogëlim të shpenzimeve. Mirëpo se në 29 kode, ta dijë z. Zijadini kemi rritje të shpenzimeve. Nëse e dimë sa kode ekzistojë, kjo deklaratë absolutisht nuk qëndron se kemi vetëm 5% rritje. Në 40% të kodeve kemi rritje të shpenzimeve.

E dyta të të hyrat vetanake po thuhet se ka rritje, por 371 mijë €, keni më pak të hyra nga aktiviteti, angazhimi i drejtorive komunale. Për gjashtë muaj 371 mijë €, më pak, por edhe gjashtë muaj të tjera bëjnë 740 mijë € më pak të hyra. Gjithashtu 1.3 milion €, i keni të planifikuara si të hyra të përnjëhershme të PPP-së e të cilat nuk jeni duke i diskutuar dhe as që janë në planet e juaja si të inkasohen këto mjete. Nga kjo del se në fund të vitit ju do t' i keni 2 milion € më pak të hyra!?

Sali Kçiku- unë e falënderoj anëtarin e Kuvendit për një “epitet” që ma dha, sepse unë qenkam “shakagji” këtu! Duhet ta dijë ky anëtar i Kuvendit se unë jam drejtor i Financave dhe jam magjistër i ekonomisë të cilin fakt e kam thënë edhe më herët.

Sa i përket raportit financiar këtij nuk do t' ia zë për të madhe, por po më habit qasja e z. Riadit i cili është ekspert i ekonomisë.

Sipas planifikimit të hyrat për vitin 2014 shumë mirë e thash janë 3 milion e 780 mijë €. Realizmi i të hyrave për janar –qershor për periudhën 2013 është 1 milion e 580 mijë €. Realizmi i të hyrave janar –qershor 2014 është 1 milion e 698 mijë €. Në bazë të kësaj nëse bëhet krahasimi i periudhave rritja e të hyrave për periudhën e vitit 2014 është afër 7%. Sa i përket planifikimit janë 455 dhe do të thotë për 5% nuk i kemi realizuar e jo si thotë anëtarin e Kuvendit që nuk i njeh financat thotë vetëm 45%. Në këtë gjysmë vjetor për 5% nuk janë realizuar të hyrat sa i përket planifikimit.

Te shpenzimet e kemi në raport –rekapitullimi i shpenzimeve-pagesat e vitit 2014 – borxhet e paguara në vitin 2013-shpenzimet vitit 2014-shpenzimet sipas gjashtë mujorit të 2013- edhe proporcioni për vitin e kaluar dhe në fund është edhe përqindja.

Me përjashtim të pagave të cilat janë rrit 30.23%, asnjë rritje tjetër nuk e kemi, të gjitha janë zvogëlime. Për hir të opinionit desha një sqarim; drejtori i Zhvillimit Ekonomik Riadi sa ka qenë për periudhën 2013 ka harxhuar; shpenzimet e udhëtimit brenda vendi mbi 430 €, shpenzime udhëtimi jashtë vendit janë harxhuar 1150 €. Mëditje të udhëtimit jashtë vendit 940 €, mbushje telefoni i ka harxhuar mbi 1287 €. Shërbime në aftësim dhe trajnim 2.800 €. Shërbimet e shtypit mbi 2670 €. Pajisje tjera, 265 €, furnizim për zyrë mbi 2890 €. Mirëmbajtje të teknologjisë informative 1360 €. Reklamë dhe konkurs 5937. shpenzimet për informimin publik 7.600 €. Mirëpo çka është absurdi dreka zyrtare i ka harxhuar mbi 15 mijë € për vitin 2013 vetëm drejtori i Zhvillimit Ekonomik. Edhe një njoftim që kërkoi kolegu, ne në raport financiar i kemi pasqyruar të gjitha obligimet. Po i përkujtoj shkurtimisht: ish drejtori i Arsimit paga ka mbet borxh 117 mijë €, mallra dhe shërbime mbi 478 mijë €, shpenzimet komunale mbi 30 mijë €, subvencione mbi 14 mijë € kanë mbet borxh për bursat e studentëve të papaguara. Shpenzimet kapitale mbi 168 mijë €. Gjithsej Drejtoria e Arsimit ka mbet borxh mbi 804 mijë €. Vetëm dreka zyrtare në Drejtori të Arsimit janë harxhuar 17 mijë e 500 €.

Riad Rashiti- më vjen keq për atë që po shqetësohet drejtori, por nuk dha përgjigje për pyetjet të cilat i bëra. Te subvencionet më intereson a e ka shkelur Rregulloren e Kuvendit komunal e që i ka ndarë mbi 2 mijë €, dy subvencione. E dyta “shaka” unë i thash drejtorit, sepse edhe është. Ja një shembull i paraqiti kursimet e shpenzimeve 100% . Është e vërtetë se në disa kategori ka 100% kursime. P.sh te qiraja për përdorim të hapësirave të parkingut te QMF-ja ne i kemi shpenzuar 600 €, kurse ju i keni

shpenzuar 300 €. Këtu keni më pak shpenzime 100% dhe ju lumtë për këtë! Në dy tri kode keni shpenzime si i paraqitni me shpenzime sa i përket raportit tuaj për drejtorinë të cilën e kam udhëheq, një listë e ka përgatitur drejtori për mua edhe pse nuk e ka pasur në rend pune. Mirëpo kjo tregon se drejtori nuk ka lidhje me qeverisje të KK-së. Nuk ke lidhje, sepse nuk ke informacione! Unë e kam udhëheq Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik me zero € buxhet! Këtë e dinë edhe kolegët nga LDK që asnjë € nuk e kam pasur buxhet! Më 2013 ju që i përmendni shpenzimet dhe të cilat nuk qëndrojnë definitivisht dhe të ka hyrë virusi me sindromën e mashtrimeve dhe gënjeshtreve që ju i bëni dhe iu ka thënë mos veproni kështu, sepse iu rritet hunda dhe do t'iu fotografojmë dhe do të turpëroheni! Disa prej juve po gënjejnë, ju lus që të mos gënjeni, mos paraqitni shifra të shpenzimeve, sepse ato shpenzime askush nuk i ka bërë. Ato qëndrojnë dhe duhet ta dijë drejtori nëse ka mësuar diçka për gjashtë muaj, sepse shpenzimet faturat prej atij kodi ku ka mjete. A janë harxhuar te Zyra e Kryetarit të Komunës apo diku tjetër, pagesat ndodhin, por jo shpenzime nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik. Ato që po thuhën janë plotësisht të pavërteta!?

Bujar Nevzadi- unë nuk mohoj atë që e tha drejtori për Arsimin edhe pse nuk pat nevojë ta thotë. Ato janë publike, por për tërë veprimtarinë time 25 vjeçare nëse dikush e dinë se kam futur diçka në xhep le ta thotë. Mirëpo për këto që janë harxhuar në Drejtori të Arsimit, ato janë publike, janë ndërtuar 7 shkolla dhe janë ndërtuar shumë kabinete. Unë nuk po hyjë në atë se sa punëtorë të arsimit i kanë pasur nga dy vende të punës, por nuk po hyjë në ato gjëra, por vetëm i bëra disa pyetje.

Sali Kçiku- unë e kuptoj drejtorin e Zhvillimit Ekonomik për shqetësim, por ky është raport financiar dhe unë mund ta jap edhe një kopje dhe në financa dy edhe dy bëjnë katër dhe jo si në politikë që mund të bëjnë edhe 8 dhe 10. Të kuptoj për shqetësimin që e ke bërë në shpenzime.

Nuk jam në dijeni dhe nuk është e vërtetë ajo që e thotë Riadi, por do ta hulumtoj dhe nuk besoj se pa vendim të kryetarit është bërë ndonjë shpenzim i subvencionit përtej vlerës së lejuar. Nëse ka ndodhur përgjigjen do t'ia jap me shkrim, por unë nuk jam në dijeni se ka ndodhur kjo?

Riad Rashiti- unë kam bërë kërkesë me shkrim ndaj drejtorit dhe të falënderoj për përgjigjen që ma ke dhënë dhe këtu thotë; subvencione për përfitues individual 5 mijë € për ndërtimin e shtëpisë x personit, me datë 14 prill. Me 3 qershor të njëjtit person i keni ndarë 2.967 €. Informacionet i kemi, por po kërkoj përgjigje a janë dhënë këto subvencione me vendim apo pa vendim?

Sali Kçiku- unë isha shumë i qartë dhe thash se e mora pyetjen dhe do ta kthej përgjigjen me shkrim!

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me këtë pikë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.1 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.1 e rendit të punës: Raporti financiar për periudhën, janar-shkurt 2014, me 25 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

Pas kësaj pike të rendit të punës, kryesuesja i liron anëtarët e Kuvendit në një pushim prej 10 minutave.

2.2. Propozim vendimi mbi qasjen e revidimit të vendimit për miratimin e zgjidhjes urbanistike të kompleksit, Shkollat e Mesme në Gjilan

Pas pauzës seanca i fillon punimet, por për një çast mungoi kryesuesja, kurse seancën e mori për obligim për ta udhëheq anëtari më i vjetër z. Zijadin Maliqi i cili për këtë pikë fjalën ia bartë përfaqësuesit të Drejtorisë së Urbanizmit, z. Mumin Kçikut.

Bujar Nevzadi- kam pyetje, pse nuk është zgjedhur zv/kryesuesi, por ju z. Zijadin po e udhëhiqni mbledhjen?

Zijadin Maliqi- nuk jam kompetent për t' u përgjigjur në këtë pyetje!

Bjar Nevzadi- sekretaria të konstatojë në proces se edhe pas 8 muaj të qeverisjes nuk kemi mundur ta zgjedhim zv/kryesuesin e Kuvendit!

Mumin Kçiku- z. Kçiku theksoi se bazë juridike për zgjidhjen e kompleksit të shkollat e mesme është Ligji mbi planifikimin hapësinor, dispozitat e vendimit për zbatimin e planit rregullues urban "Zona 1" në kuadër të cilit plan ka qenë i përfshirë ky kompleks i cili është miratuar në vitin 2010, kurse vendimi për zgjidhjen urbanistike është miratuar me 2012. Në vijim të fjalës së tij z. Kçiku dhe edhe sqarime të tjera detale e të cilat anëtarët e Kuvendit i kanë në material të seancës.

Qefsere Sadriu- vendimi ka kaluar në vitin 2012, por këtu është vetëm një ndryshim vogël, për të cilin ndryshim po e bëj prezantimin me anë të kino-projektorit. Është hapësira ku do të vendoset Shkolla e Muzikës dhe hapja e rrugës për këmbësor e cila është tek pjesa ekzistuese dhe pjesa në të cilën do të vendoset nënkalimi. Në vazhdim zonja Sadriu me anë të kino-projektorit e demonstroi këtë projekt.

Ismet Hajdini- kam një pyetje lidhur me nënkalimin dhe ky nënkalim i dedikohet këmbësorëve apo nxënësve?

Qefsere Sadriu- ky nënkalim është vetëm për nxënës.

Mevlyde Zejnullahu- unë kam pyetje se çka është ndërmarrë për objektin e Drejtorisë së Arsimit dhe Inspektoriatit të Arsimit, sepse ai është objekt i cili nuk i plotëson aspak kushtet. A është paraparë që të bëhet ndonjë objekt i ri apo të bëhet ndonjë renovim? Gjithashtu ku parashihet të vendoset Shkolla e Mjekësisë?

Myzaferre Ismaili- vendimi mbi revidimin e qasjes urbanistike të kompleksit të shkollave të mesme është tejtejet i domosdoshëm. Edhe pse ky propozim ishte bërë në vitin 2012, gjer më tash nuk është punuar asgjë në këtë drejtim. Kjo pjesë është zonë edukativo-arsimore dhe fluksi i nxënësve është jashtëzakonisht shumë i madh dhe shumë herë nuk dallohen nxënësit dhe qytetarët e rëndomtë. Për këtë arsyeje një rrethojë për këtë kompleks është më se i domosdoshëm, por mendoj se do të jetë edhe i dobishëm për identifikimin e nxënësve, si për nga uniforma që e bajnë në shkollat e tyre, por edhe do të jetë edhe siguria më e madhe e nxënësve. Një rrethojë në këtë kompleks do të zvogëlonte me të madhe incidentet në mes të nxënësve, sepse menjëherë do të identifikoheshin, kurse qytetarët nuk do të kishin qasje në këtë kompleks shkollor. Rregullimi i këtij kompleksi

do të ishte një zgjidhje e mirë si për nxënës ashtu edhe për qytetarë, sepse në afërsi të objektit të Postës së Vogël në rrugën për hyrje të objektit tregtar Wiva në drejtim të konviktit mbyllet kjo rrugicë te objekti i Drejtorisë së Pylltarisë dhe do të ndërtohet një vend kalim ku do të mundësohet që në këtë pjesë të kalojnë vetëm nxënësit. Kjo rrugë shumë herë ka sjell shumë probleme në mes të nxënësve dhe qytetarëve, sepse çdo kush ka pasur qasje në shkollat e mesme dhe kanë sjell shumë probleme duke penguar procesin mësimor. Me rregullim të kompleksit do të krijojmë kushte dhe mundësi për një qarkullim, lëvizje, komunikim dhe siguri si për nxënës dhe qytetarët e komunës sonë.

Fehmi Sylejmani- u bë elaborimi i këtij Plani, por arsyet e revidimit të këtij vendimi të cilat janë cekë në arsyetim për mua nuk janë të qëndrueshme. Janë disa gjëra që të bëjnë për të dyshuar pse? Unë mendoj se rrethoja ashtu si ka qenë edhe më parë duhet të jetë, ndoshta me ndonjë modifikim më të mirë dhe besoj se zonja arkitekte edhe njëherë do të na jep sqarime. Mirëpo disa arsyeje që po epen tash, nuk po më pëlqejnë aspak. Së pari është në kundërshtim me Planin rregullues “Qendra Z-1” dhe është mirë të na epen sqarime pse? Ngarkesa e madhe e hyrjeve (qasjeve), mendoj se nuk është e qëndrueshme, prandaj më mirë do të ishte vetëm një hyrje, sepse nuk do të bëhet aq sa po mendoni ndonjë grumbullim i madh në hyrje. Objektet shkollore janë objekte të shpërndara, por edhe kjo nuk qëndron, sepse nuk janë të shpërndara me shumë kilometra dhe shpërndarja është në distanca shumë të vogla. Objektet private dhe shtëpitë e kanë hyrjen jashtë rrugës së kompleksit. Unë dhe grupi i LVV jemi për një rrethojë ashtu si duhet dhe si i ka hije kompleksit të shkolla, sepse ajo, jo vetëm se ka siguri dh nëse bëhet ashtu si duhet do ta rrit edhe cilësinë në arsim dhe do t’ i mënjanojë të gjitha telashet të cilat po paraqiten. Mendoj se dhe njëherë është mirë ta modifikoni këtë projekt. Mandej Komuna duhet të bëjë më shumë për këtë kompleks dhe objektin e Pylltarisë duhet ta heq nga ai kompleks, sepse ky objekt shumë e pengon Gjimnazin e Ri, ai ka zënë derën, nuk ka hyrje për këtë Gjimnaz.

Arben Maliqi-është e vërtetë se ky projekt ka filluar në vitin 2012, mirëpo unë mendoj se një revidim ka qenë i nevojshëm. Arsyeja është shumë e qartë, sepse kemi të bëjmë me pjesën më vitale të qytetarëve dhe nxënësve tanë. Unë mendoj se duhet të fokusohemi në katër-pesë pika e të cilat janë me shumë rëndësi: së pari objekti i Ekonomisë së Pyjeve, patjetër duhet të rrënohet dhe lirohet ajo hapësirë. Mandej te pjesa e objektit tregtar “Wiva”, pjesa e parkingut duhet të shihet se a i ka kaluar afati, sepse ne vetë kemi marrë vendim, por ajo pjesë patjetër duhet t’ i kthehet Shkollës së Mesme Ekonomike. Mandej duhet të mendohet se Stadiumi i qytetit i cili realisht është një terren, i cili Stadium duhet t’ i mbetet shkollave të mesme. Kjo duhet të parashihet, sepse në të ardhmen është paraparë që të ndërtohet një Stadium tjetër. Të mendohet se brenda një periudhe të shkurtës 4-5 vjeçare ai stadium të mbetet për shkollat e mesme. Mandej te Universiteti, unë e kam parë se aty është vendosur një pengesë, por nuk e di se për çfarë arsye është ajo pengesë dhe pse ne mos të mund të kalojmë aty? Ne patjetër duhet të hyjmë me veturë, sepse kam edhe mjete dhe rekuizita sportive. Duhet ta kemi parasysh se aty e kemi edhe objektin për Rehabilitimin e Gruas, ky institucion rehabilitues ia vlen shumë, por nuk e ka vendin aty! Duhet të mendojmë t’ i gjejmë një hapësirë kësaj shoqate dhe t’ i largojmë nga ky vend. Duhet menduar dhe studiuar mirë se çka duhet bërë në këtë kompleks dhe ka nevojë për një rrethojë ashtu si i ka hije, të krijohet një rend dhe disiplinë në mënyrë që nxënësit tanë të edukohen dhe të mësohen ashtu siç iu ka hije.

Riad Rashiti- përsëri në emër të grupit, por së pari e shpreh shqetësimi tim se shumë

vendime po na vijnë e të cilat janë në kundërshtim me ligjin. Së pari ky vendim për revidimin e zgjidhjes urbanistike të kompleksit të shkollave, mendoj se është në kundërshtim me Ligjin 042174 për Planifikimin hapësinor, sepse ky plan është miratuar në vitin 2012, prandaj para pesë vite Komuna nuk ka të drejtë për të ndërhyrë në revidim të planeve urbanistike. U dha një arsytim nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Urbanizmit, por nuk qëndron ajo se nuk ka pasur debat me qytetarë? Ne kemi të dhëna të sakta se është mbajtur debati me qytetarë, prandaj nuk është mirë të thuhet ato që nuk qëndrojnë. Ne konstatojmë se arsyeja pse po ndodh ky revidim ka të bëjë me realizimin e interesave të individëve dhe pronarëve të caktuar. Gjithashtu propozimet që i keni sjell sot kanë qenë edhe në kohën kur është miratuar ky plan rregullues në vitin 2012. Mirëpo nuk është miratuar ajo që dy-tre pronarëve t' i sigurohet qasje përmes Administratës së Gjimnazit. Prandaj nuk është mirë që për një kërkesë të një individi të ndërhyhet në këtë plan dhe të veprohet jashtëligjshëm. Me sa e di në këtë material nuk na është paraqitur asnjë ankesë me shkrim nga ndonjë pronarë për kohën kur është miratuar ky plan rregullues. Ne mendojmë se është ndërhyrë në këtë plan për t' i realizuar interesat e individit i cili e ka filluar një objekt i cili është me leje, por ai objekt është lëshuar në kundërshtime me kriteret urbanistike. Ne e kemi kërkesën e tij të cilën e ka bërë para dy vite e cila është refuzuar dhe e kemi kërkesën që u është lëshuar leja me kushte të reja të këtij viti. E që konsiderojmë se edhe kjo është një shkelje e ligjit për ndërtim. Sa i përket propozimit të kolegëve të mi për ndërtimin e rrethojës së kompleksit të shkollave të mesme është mirë që ta propozojmë për investim, por unë do t'ia kujtoj se ata që kanë anëtarë të këtij Kuvendi edhe në mandatin e kaluar se është prezantuar dy herë ai projekt, ekziston në mënyrë të detajuar dhe është miratuar nga KK për investime përmes PPP-së. Ky projekt i detajuar i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore dhe është miratuar nga Ministria e Financave, gjegjësisht Ministria Qendrore e PPP-së. Komuna e Gjilanit i ka zhvilluar të gjitha procedura e prokurimit publik në mënyrë të ligjshme dhe nuk ka pasur asnjë ankesë nga pjesëmarrësit në tender. Nuk ka pasur asnjë ankesë as nga opozita e atëhershme dhe nuk ka as sot nga Qeverisja Komunale sa i përket projektit i cili është miratuar dhe procedurat të cilat i kemi ndjek në qeverisjen e kaluar. Ne kemi kërkuar që nga fillimi i mandatit që të vazhdojnë procedurat dhe mos të bllokohen investimet në vlerë prej 800 mijë €, dhe për të cilat është pritur vetëm nënshkrimi i kontratës me operatorin i cili i ka plotësuar kushtet për ta përfituar atë projekt. Nëse ka vërejtje është mirë Komuna e Gjilanit t' i analizojë ato dhe t' paraqes. Nëse nuk ka vërejtje nuk ka nevojë që të bëhen propozime, nuk ka nevojë që të bëhen projekte, sepse ato ekzistojnë të gjitha dhe pritet vetëm momenti i nënshkrimit të kontratës dhe e lus kryetarin dhe drejtorin për Zhvillim Ekonomik të cilave i kam bërë edhe kërkesë me shkrim që të vazhdojnë procedurat për të filluar investimet në krijimin e kushteve më të mira të rrethojës dhe infrastrukturës tjetër të nevojshme në kompleksin e shkollave të mesme përmes PPP-së. Komunës së Gjilanit nuk i kushton asgjë për rregullimin e kësaj rrethoje, sepse të gjitha investimet i bën PPP, kurse Komuna e Gjilanit e ka interesin e vetë shumë të madh. Unë kërkoj që të nënshkruhet kontrata për investime në këtë kompleks.

Jonuz Hasani- unë dëshiroj ta shtjelloj çështjen e nënkalimeve, sepse është një projekt shumë i mirë për qytetarin e Gjilanit, por duhet pasur kujdes gjatë ndërtimit të nënkalimit, sepse afër shkollës së Velekicës ekziston një nënkalim, por ai nënkalim nga të reshurat atmosferike vërshohet nga ujërat dhe vështirësohet kalimi i udhëtarëve. Për këtë arsyeje është mirë që të bëhet një punë e kujdesshme e paraparë sipas të gjitha standardeve dhe mos të ndodh që të i kthemi kësaj pune prapa. Duhet të jetë një kujdes maksimal gjatë zbatimit të punëve.

Imet Rrahmani- unë këtu po shoh zyra shumë të mira, por arsyeshmëria e ardhjes në Kuvend për revidim të këtij projekti po mendoj se ia vlen me vetë faktin se shumë nga anëtarët e Kuvendit kanë kërkesa të reja e të cilat janë të reja, por sa e kuptova unë janë marrë për bazë edhe kërkesat dhe vërejtjet e qytetarëve.

Ky kompleks është në qendër të qyteti dhe jemi në dijeni se në çfarë gjendje është tash, propozoj që ky projekt mos të mbetet vetëm në letër, por të fillojmë për të marrë masa konkrete për krijimin e një ambienti më të përshtatshëm. Jam kundër rrethojave klasike, sepse në fëmijë tanë duhet t'iu krijojmë një hapësirë të mirë për edukim dhe shkollim, kurse rrethojat klasike na asocicojnë në diçka negative për syrin e njeriut.

Jam për rrethoja të gjelbra, me qasje të shumta, pa penguar qasjen e nxënësve në shkolla, por edhe pa e penguar qarkullimin e qytetarëve. Kërkoj që rrethojave klasike t'iu ikim, të mos mbetet kjo vetëm në letër dhe t'iu kemi parasysh hapësirat e gjelbra.

Avdyll Aliu- nuk e kam të qartë se kujt po i duhet morali i dyfishtë në Kuvend? Nuk ka nevojë këtu për moral të dyfishtë! Unë patjetër nganjëherë po duhet të kthehem në kohën e kaluar kur kam thënë (kur ne kemi qenë në anën e juaj, kurse ju këtu). Ju kujtohet mirë Fidanishtja? Pas 4 muajve ne e kemi ndryshuar atë plan rregullues! Për këtë e pyes a vlen edhe në këtë rast Ligji për planifikim hapësinor? A ka ndryshuar diçka dhe a është ai ligj dhe ai nen? Atëherë ka qenë e ligjshme të bëhet revidim pas katër muajve, kurse tash nuk po bën!? Nuk është fjala për një rrethojë, është fjala për një organizim total në të gjitha aspektet e infrastrukturës. E tërë kjo është në funksion të mirë edhe për shkollat edhe për qytetarët!

Zyrtari i Urbanizmit e tha mirë baza juridike është e mjaftueshme dhe kënaqshme.

Ligji 03/L-040 i LVL, Ligji 04/2-174 i Planifikimit hapësinor të Republikës së Kosovës dhe është Statuti i Komunës së Gjilanit. të gjitha këto janë bazë juridike për ta propozuar këtë projekt. Ky revidim vetëm se duhet të bëhet në përpunim me planin rregullues “Qendra 1” i cili është miratuar në maj të vitit 2010. Do t'iu kalojë të gjitha fazat e nevojshme dhe të ketë pjesëmarrje relevante gjatë këtij riplanifikimi. Siç u tha një nevojë e tillë rrjedh për kërkesave dhe ankesave të qytetarëve për krijimin e kushteve dhe mundësive për një komunikim qarkullim dhe lëvizshmëri më të përshtatshme që nga Dardania dhe anasjelltas, por edhe një qarkullim të mirë për brenda vetë kompleksit të shkollave. U tha se është një kërkesë për ndërtimin e një shkolle dhe kjo të detyron për ta bërë një riorganizim dhe një mangësi ka qenë kur është marrë ky vendim qytetarët nuk kanë qenë pjesëmarrës në debat publik dhe janë eliminuar nga ky planifikim. Ju ftoj që ta votoni këtë pikë të rendit të punës dhe të fillohet me zbatimin këtij riorganizimin.

Nevzad Isufi – pasi që po bëjmë fjalë për një projekt konkretë, duhet paraqitur edhe nga Drejtoria e Urbanizmit një tabelë me pamje ku do të shihet se për çka bëhet fjalë. Nëse po flitet prej shumicës për një nënkallim, pra po flitet për ndryshime të pjesshme dhe nuk po flitet për ndryshime në tërësi, atëherë pse nuk është propozuar që të kemi modifikim përkatësisht plotësim, por jo një revidim. Shtrohet pyetja për drejtorinë e cila nuk ka mundur ta realizojë një projekt deri më tash, ende pa filluar realizmi, por kërkohet të bëhet një revidim i tërësishëm. Në bazë të cilave kërkesa po bëhet ky revidim, sepse po e thoni në bazë të kërkesave, kurse ne nuk kemi informatë sa qytetarë janë dhe cilat kërkesa konkrete janë të qytetarëve? Nëse thuhet se kompleksi i shkollave duhet të dallohet për shkak të qasjes dhe specifikës që ka, atëherë si mund të jetë kompleks i shkollave ku qytetarët mund të kenë qasje nga të gjitha anët në hapësirat shkollore. Kjo për mua është pakapshme. Nëse mendohet të ketë një qasje për shkak të sigurisë dhe për shkak të

mbarëvajtjes së procesit mësimor, atëherë duhet të ketë një dallim. Nëse janë në pyetje rrugët në kemi thënë se rrugët duhet të jenë nga ana e stadiumit dhe pjesa tjetër në drejtim të Fakultetit të Edukimit. Bëhet fjalë për 20-30 metra dallim në qasje si për pjesën e qytetit brenda si për pjesën nga Dardania. Mos është fjala këtu për qasje të disa personave privat të cilët veç kanë hapur qasje në oborret e shkollave si në Gjimnaz dhe të Shkollës Teknike e që do të thotë se është e kundërligjshme. Oborri i shkollave është edhe oborr i fqinjëve e që do të thotë është e paligjshme dhe askund nuk kemi qasje të tilla. Nëse është bërë kjo nga presioni i qytetarëve, atëherë duhet thënë se këto janë qasje të paligjshme, sepse ato janë shtëpi individuale. Nëse kemi revidim vetëm të një pjese, atëherë pse të shkohet me shpenzime shtesë, të shkohet me riprecudurim të gjitha këtyre fazave dhe të pritët edhe gjashtë muaj dhe të fillojë zbatimin. Kemi të bëjmë me të njëjtin ekip i cili ka punuar edhe më herët, janë dhënë vërejtjet me kohë, por tash përsëri kërkohet revidim. Mendoj se këtu kemi nevojë për një sqarim të tërësishëm të detajuar, pse dhe cilët janë ata qytetarë të cilët kërkojnë ndryshime. Sa është numri i atyre qytetarëve, sa janë të arsyeshme ato kërkesa? Po ashtu të mendohet pak edhe për çmimin që i kushton Komunës dhe mos të shkojmë në revidim të tërësishëm nëse nuk ka nevojë vetëm për ndryshime të vogla.

Bajram Hasani- qasja e revidimit për miratimin e zgjidhjes urbanistike të kompleksit të shkollave të mesme, unë pasi që jam edhe anëtar i Komitetit të Urbanizmit është bërë një analizë më detale, mirëpo mua po më brengos fakti se ky projekt është punuar nga i njëjti ekip profesionistësh dhe po i njëjti ekip e mbron fuqishëm këtë revidim.

Unë jam për qasje të revidimit, sepse do të organizohet debati publik si janë procedurat, mirëpo mendoj se më mirë të jetë një grup jashtë drejtorive komunale në mënyrë që të hartohet një projekt i mirë dhe mos të kemi probleme gjatë zbatimit.

Ne në komitet e kemi pyetur përfaqësuesin e Urbanizmit se a po e shkelim ligjin nëse ne hapim qasje dhe përgjigja ka qenë që sipas ligjit të ri janë procedurat të cilat e mundësojnë hapjen e kësaj qasje.

Mandej pasi kryesuesja nuk ma dha fjalën në pikën e parë po e shtoj tash se sa i përket shpenzimeve, kërkoj që shpenzimet për mbushje apo diçka tjetër, t' i mundësohet stafit të Komunës si p. sh inspektorëve dhe jam i bindur se ata nuk kryejnë punën ashtu si duhet nëse nuk i ofrohen kushtet. Nëse i bëhen kufizime edhe sa i përket mbushjeve telefonike dhe karburanteve. Unë jam për atë që shërbimi nuk guxon të ulet pavarësisht çmimit, por duhet të arsyetohet ai shpenzim.

Bujar Nevzadi- unë e kam thënë edhe në komitet të fundit se fare pak po ka ndikim fjala jonë, por e dinë të gjithë një mandat kam qenë drejtor i Arsimit dhe jam në rrjedha se si është vepruar me këtë kompleks, mirëpo është kot të flasim, sepse janë gishtat dhe ata vendosin ndryshe.

Së pari ndoshta është Komuna e rrallë në Kosovë që e ka mundësinë për ta ndërtuar kompleksin e shkollave. Kërkoj të më bind dikush pse po bëhet ky revidim, të ma argumentoj dhe jo vetëm po e bëj një ndërrim! Ne e kemi quajtur kompleks të shkollave dhe cila është arsyeja që këtij kompleksi mos t' i hapim rrugë? Nuk qëndron ajo që nuk kemi debatuar me qytetarë, kemi debatuar bile edhe atë gjatë dy vite kemi bërë debat.

Kemi debatuar me shumicën e qytetarëve të asaj pjese edhe me prindër dhe drejtorët e shkollave. Të ndalemi dhe të bisedojmë si prindër. A më mirë është si prindër kur fëmijën ta dërgosh në shkollë ta kesh të sigurt, sepse hyn në një hyrje dhe futet në kompleks!

Fëmijët e kanë sigurimin e kanë hyrjen dhe të tjerët më nuk mund të hyjnë. Unë mendoj se të gjithë qytetarët kërkojnë për ta pasur fëmijën e sigurt e dërgon fëmijën në shkollë

Ne e kemi pasur mundësinë ta bëjmë rrethojën, sepse i kemi shkollat në një kompleks. Te shtëpitë private është bërë biznes, kurse ju po propozoni për ta lëshuar ne pronën tonë shkollore për t'ia liru arë rrugën atyre për biznes. Ato katër –pesë familje të keni të hyra, kurse ne ta dëmtojmë shkollën për shkak të 4-5 familjeve. Unë nuk besoj se dikush pajtohet me këtë për t'ia rehatuar 4-5 familje, kurse 9 mijë nxënës të sillen anë e mbanë të pasigurt. Unë e di që e votoni, por të jetë në evidencë që po e deklaroj se po dëmtoni një projekt të kompleksit të shkollave të shkëlqyeshëm dhe dëshira më e madhe ka qenë që ta përfundoj këtë projekt. Unë jam për ta plotësuar dhe ndryshuar në të mirë të kompleksit, por jo ashtu si e keni paraparë ju dhe nuk keni arrit të më bindni se po bëni revidime te efektshme dhe sikur te ishte ashtu, unë pa hezitim do ta votoj. Shtëpia e cila është ndërtuar afër Gjimnazit dhe i keni dhënë leje nuk e di sa është në harmoni me planin dhe nuk e di interes i kujt ka qenë ndërtimi i atij objekti aty?

Leonorë Bunjaku- unë në mandatin e kaluar kam qenë edhe anëtare e Komitetit të Urbanizmit në mandatin e kaluar dhe qëndron ajo se është punuar gjerë e gjatë dhe me përpikëri nga të gjithë anëtarët e komitetit. Revidimi i vetëm i cili kishte me qenë i mirëseardhur në këtë plan rregullues kishte me qenë shpronësimi i shtëpive private dhe kompensimi i tyre nga ana e Komunës. Në këtë mënyrë do ta lehtësonim kompleksin dhe do të ishte bërë një kompleks i përkryer. Sa i përket gjërave tjera besoj se nuk do t'ia ndihmojë ndonjë revidim. I vetmi revidim i cili duhet të bëhet të cilin e kam kërkuar edhe në mandatin e kaluar është që të bëhet shpronësimi i atyre pronave private e të cilat fatmirësisht janë të pakta. Ata pronarë të 3-4 shtëpive kanë krijuar edhe rrugë të tjera për shkak të bizneseve të tyre dhe pengojnë qasjen e nxënësve dhe mësimitdhënësve në atë kompleks. Nëse ka mundësi që të bëhet shpronësimi është e vërtetë se do ta ndihmonte krijimin e një kompleksi me të gjitha standardet dhe ato biznese nuk do të funksionojnë, sepse brenda kompleksit do të jetë edhe restoranti i cili do t'ia shërbejë me çmime simbolike nxënësve dhe mësimitdhënësve. Unë kërkoj nga të gjithë që të krijojmë kushte dhe mjete për ta bërë shpronësimin e atyre tri ose katër shtëpive private për të qenë kompleksi i përkryer. Sa i përket objektit të pylltarisë mendoj se është një rast urgjent, sepse është vështirë qasja e mësimitdhënësve dhe nxënësve brenda një hyrje. Urgjentisht duhet të bëhet rrënim i atij objekti pasi që ai është mjaft i degraduar.

Riad Rashiti-unë desha shkurtimisht ta bëj një krahasim lidhur me atë që shefi i grupit të LDK-së e ngriti, kur është bërë ndërhyrja e planit rregullues të Fidanishtja. Është e vërtetë kjo, por atëherë kanë ekzistuar të gjitha dëshmitë dhe ka qenë arsyeshmëria e bazuar në ligje, sepse kemi paraqitur para KK ankesa të qytetarëve të Komunës së Gjilanit për të ndërhyrë në këtë plan urbanistik, sepse janë dëmtuar rëndë për t'ia shfrytëzuar pronat e tyre që i kanë në atë zonë. Kanë qenë disa kërkesa të disa pronarëve të cilët kanë qenë jashtë Kosovës, por kur janë organizuar debatet publike nuk kanë qenë në Gjilan dhe nuk kanë pasur mundësi për të dhënë vërejtje. Mirëpo ata pasi kanë ardhur në Gjilan janë paraqitur në Drejtorin e Urbanizmit dhe kërkesat e tyre kanë kaluar në Komitetin e Urbanizmit dhe në KK të Gjilanit. Ne për këtë kemi thirr seancë të veçantë, sepse është obligim ligjor i KK për ta mbrojt zhvillimin mirëfilltë të qytetarëve të Gjilanit pa dallime partiake.

Arben Maliqi- për ta marrë fjalën më nxiti debati edhe i pozitës dhe opozitës dhe për mua ishte një kënaqësi dhe gjithmonë në këtë mënyrë duhet të debatojmë dhe duhet t'ia qartësojmë gjërat. Mua po më brengos fakti pse nuk është drejtori i Arsimit këtu dhe a ka pasur bashkëpunim me drejtorin e Arsimit? Sot drejtori i Arsimit ka qenë desh të jetë këtu,

sepse po bisedohet për një çështje me shumë rëndësi për nxënësit tanë.

Sa i përket shpronësimit të shtëpive, por vërtetë ne duhet ta gjejmë një zgjidhje, sepse ato shtëpi që janë aty janë të shenjta. Ne duhet ta gjejmë një solucion qysh t' i shpronësojmë ato shtëpi në mënyrën më të mirë, por është e pamundur, sepse duhet miliona €.

Ish drejtori i Arsimit sot ka qenë në nivel dhe që nga koha kur është në opozitë më ka pëlqyer më së tepërmi. Kur është fjala për arsim, është fjala për fëmijët tanë, prandaj duhet ta analizojmë mirë se si po veprojmë? Kështu që duhet ta gjejmë një zgjidhje e cila është më e mira pa dallime. Po shihet kompleksi, por a mund të realizohet kjo në këtë mënyrë është pikëpyetje. Edhe fushatat kur t' i rregullojmë të kemi gjëra të mira më shumë të kemi gjelbërim më shumë dhe t' i largohemi betonit. Për arsim nuk duhet kursyer asgjë, sepse çka të investojmë në arsim ajo është për të mirën tonë.

Fehmi Sylejmani- jo për ta kundërshtuar doktorin Imet me të cili pajtohem plotësisht se rrethoja na asocicon në diçka tjetër, por megjithatë rrethoja në kompleksin e shkollave të mesme është diçka që ia vlen. Kjo rrethojë shkollave i jep tjetër tretman dhe tjetër hijeshi kompleksit, por me këtë është edhe siguria më e madhe.

Unë e kam një njoftim nga Drejtoria e Urbanizmit për të cilin në mbledhjen e kaluar kam kërkuar, çfarë plani dhe çfarë leje iu ka dhënë personit për të cilin po flasim? Ky person edhe më parë tri herë ka kërkuar leje, por asnjëherë nuk iu ka dhënë leja. Tri herë Ministria për Mjedis dhe Planifikim e ka kthyer lëndën, kurse për herën e katërt Drejtoria e Urbanizmit në Gjilani ia jep leje dhe në arsyetim thotë: Plani rregullues urban "Qendra Zona 1". Unë mendoj se drejtori i Urbanizmit duhet të na jep sqarime se çka është Plani rregullues urban "Qendra, Zona 1", por me theks të veçantë të shkollat mesme.

Gjithashtu kam mospajtime se dhe këtu iu ka dhënë 80 me 20% e që unë mendoj se aty nuk është 80, por 100%. Këtu ka arkitekt dhe profesionist tjerë dhe sipas standardeve duhet të jetë 60 me 40%. Drejtoria e Urbanizmit mund ta jap një arsyetim, por nuk ka fakte të bindshme. Mandej ne po e shohim në plan P+4, por realiteti sipas të gjitha gjasave do të na del P+P+4 e që i bie 6 kate do të ndërtohet dhe do t' ia zë frymën Gjimnazit të Vjetër, do ta shëmtojë tërë këtë projekt të cilin po e shohim aq bukur të projektuar. Ne nuk mund askujt t' i ndalojmë për të marrë leje, por leje për kaq kate mund t' ia ndalojmë. Unë mendoj se Drejtoria e Urbanizmit këtë vendim duhet ta rishikojë edhe njëherë, sepse po merr përgjegjësi të madhe për dhënie të kësaj leje, sepse ky objekt në një mënyrë e shëmton tërë këtë kompleks.

Valentinë Rexhepi Bunjaku- ju të nderuar anëtarë të Kuvendit i dhatë vërejtjet e juaja, por ne mund ta hedhim në votim, por nëse nuk pajtoheni, atëherë po e shtyjmë për debat edhe njëherë këtë pikë të rendit të punës për seancën e radhës.

Ismet Hajdini- unë po flas si qytetarë i asaj lagjeje dhe interesi i "Dardanisë I dhe II" është që ky kalim të mbetet. I vetmi kalim në qytetin e Gjilanit për këmbësor është kjo hapësirë. U përmend këtu që të ketë qasje nga Fakulteti, por të gjithë e dimë sa është gjerësia e atij trotuari i cili nuk mjafton as për studentë, kurse për disa mijëra banorë do të jetë shumë rëndë. Nuk e di pse po e potenconi aq shumë rrezikshmërinë, në bazë të statistikave a ka ndonjë të dhënë sa nxënës kanë humbur jetën, sa janë lënduar dhe sa konflikte ka pasur për të cilën arsye medoemos duhet të thuret ky kompleks.

Interesi i qyfterëve të "Dardanisë I dhe II" është që të kalojnë nëpër atë hapësirë.

Valentinë Rexhepi Bunjaku- unë e sqarova mirë, nëse arsyetohet mirë po e aprovojmë, nëse jo po e shtyjmë?

Mumin Kçiku- unë po flas nga baza juridike dhe u tha se më parë kemi ndryshuar plane herë me afat herë pa afat! Mirëpo së pari po iu them se Ligji për planifikimin hapësinor është i vitit 2013, në gusht i cili i obligon të gjitha komunat që të gjitha nivelet e planeve aty ku ka hapësirë t' iu qaset ndryshimeve ose revidimeve. Është e vërtetë se Ligji për planifikim hapësinor nuk e njeh termin zgjidhje urbanistike dhe për këtë arsyeje unë kam propozuar plotësim dhe ndryshim, sepse si tillë është miratuar edhe në KK. Ishte term me vend i përfaqësuesit të VV që e quajti modifikim. Mirëpo plotësimi dhe ndryshimi i planeve bëhet me debate dhe me pjesëmarrje të qytetarëve. Kërkesa me shkrim që u potencuar, ne nuk kemi kërkesa me shkrim, por ne si zyrtarë çdo ditë jemi në kontakt me qytetarë nga të gjitha lokacionet dhe ata kanë shprehur brengosje dhe nuk është e thënë që të kemi vetëm kërkesa me shkrim siç ka qenë rasti të Agmia. Më parë afati për ndryshim të planeve ka qenë 5 vite, kurse tash është 8 vite, por nuk do të thotë se Komuna për interesa të veta mos të bëjë ndërhyrje. Ndërhyrje në rastin konkret kemi me organizim që nuk kemi ne mundësi për të bërë një modifikim pa e trajtuar këtë çështje në Kuvend nga që kemi të bëjmë me një objekt. Objekti ka të bëjë me kërkesën e Ministrisë së Arsimit për ndërtim të Shkollës së Muzikës. Shkolla e Muzikës është për nxënës tanë, Sa i përket rrugës të cilën pronarët privat e shfrytëzojnë në drejtim të Gjimnazit, rruga sipas Planit rregullues urban "Qendra Zona 1" ka qenë e paraparë në pronat e tyre. Me rastin e zgjidhjes urbanistike ajo nuk është trajtuar dhe ato rrugë nuk do ta prekin pronën publike. Nënkalimi bëhet për kalim internë të nxënësve me qëllim që mos të krijohet fluksi i madh i nxënësve me qytetarë. Objekti i Ekonomisë së Pyjeve, nuk jam në rrjedha, por ajo është diskutabile në mes Komunës dhe AKP-së.

U përmend leja për ndërtim të një objekti afër kompleksit të shkolla, por ajo leje iu është lëshuar në bazë të vendimit të Ministrisë për Planifikim Hapësinor e cila na e ka kthyer lëndën tri-katër herë. Parametrat të dhëna me leje janë plotësisht në harmoni me Planin rregullues urban "Qendra 1" edhe për këtë vendim do të bëhet debat me banorë të lagjes dhe mësimdhënës dhe të gjithë të interesuarit.

Ismajl Jonuzi- pasi që ky projekt bie në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik gjegjësisht si projekt i PPP-së menjëherë pas emërimit në pozitë të drejtorit me një staf të kufizuar të drejtorisë kemi trajtuar me prioritet ty projekte; Transporti publik dhe Kompleksi i shkollave të mesme. Me vetë faktin kompleks i shkollave të mesme, kuptohet se janë të gjitha shkollat e mesme, por në këtë rast nuk e kemi gjendjen faktike se janë të gjitha shkollat e mesme, por e kemi edhe Universitetin i cili është i përfshirë në këtë kompleks.

Duke e marrë parasysh pozitën gjeografike edhe rëndësinë e kufizimit që për sa do të jetë i suksesshëm atë koha do ta tregon, sepse kufizimi i fëmijëve dhe nxënësve nuk është i lehtë dhe nuk e besoj se shumë lehtë do ta kalojmë këtë projekt edhe pse si i tillë duket i mirë. Qëllimi i revidimit, apo një modifikim ndryshimi nuk është propozuar për interesa të akujt dhe iniciativa ka ardhur së pari nga unë duke e parë rëndësinë e aksit rrugor që e lidhë "Dardaninë I dhe II" me qytetin. Duke mos e rrezikuar projektin nëse bëhet një nën kalim, por ai nënkalim bëhet i dëmshëm sepse e rrezikon Universitetin me shkollat e mesme, sepse nuk e kanë trajtimin e njëjtë. Te Universiteti janë të hapura dyert dhe nuk mund të trajtohet njësoj si shkollat e mesme. Ky projekt nuk ka të bëjë me interesin askujt, por në fund të fundit nëse ka interesa qytetari ne nuk jemi kundër interesave të qytetarëve. Leja dhe gjërat tjera është Urbanizmi dhe drejtoritë e caktuara dhe nuk është punë e imja për të hyrë në planet rregullative. Ideja ka qenë që nga ky projekt në të ardhmen qytetarët të mos kenë probleme nëse mbyllet kjo rrugë.

Në vijim të fjalës së tij z. Jonuzi dhe sqarime edhe në kino-projektor.

Bujar Nevzadi- unë i dëgjova të gjithë, por mua nuk m' u dha përgjigje, prandaj po pyes: “a më me rëndësi është fëmijët tanë të shkojnë në kompleks të shkollave dhe fëmija të jetë i sigurt , apo prindërit të ecin edhe 200 m më tepër”? Për këtë nuk mora përgjigje !

Ne kemi biseduar edhe me rektorin e fakulteti dhe kemi thënë se duhet të shtyhet edhe 2 metra rrethoja e fakultetit, pastaj të rregullohet rruga në drejtim të stadiumit që del te Shkolla Teknike dhe në këtë mënyrë unë mendoj se çdo qytetarë do të ketë më tepër dëshirë që ta ketë fëmijën e sigurt. Unë mendoj se më mirë është që kompleksi i shkollave të rregullohet dhe nxënësit të hyjnë me një hyrje dhe të jenë të sigurt, sepse edhe ne nuk kemi qenë pa probleme në këtë aspekt.

Fehmi Sylejmani- propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër dhe të jemi më të përgatitur. Mos të ngutemi për ta hedh në votim, prandaj propozoj që kjo pikë të shtyhet për një seancë të radhës.

Valentinë Bunjkau –Rexhepi – materiali iu ka ardhur me kohë u dhanë sqarime të mjaftueshme nga zyrtarët e drejtorisë dhe mendoj se nuk ka nevojë të shtyhet për seancë të ardhshme.

Riad Rashiti- unë vetëm një pyetje e kam për sqarim, sepse po më duket pak konfuze, sepse drejtori i Zhvillimit Ekonomik tha se ky revidim është bërë me kërkesën e tij, kurse zyrtari i Urbanizmit me kërkesën e qytetarëve. Dua ta di më saktësisht :”cili është interesi i Komunës”? Të na sqarohet me dy fjali cili është interesi i Komunës për këtë ndërhyrje në këtë revidim, vetëm këtë po e kërkoj me dy fjali!?

Në fund e mbështes propozimin e përfaqësuesit të LVV për ta shtyrë këtë miratim të këtij revidimi, sepse unë kam shumë paqartësi.

Arben Maliqi- është e vërtetë se as nuk po ngutemi, por as nuk po vonohemi! Unë e lus edhe drejtorinë t' i ketë parasysh edhe këto vërejtje që i dhamë në se ka mundësi dhe ato që janë të mira dhe pozitive t' i fusim. Unë jam për të votuar, por ato propozime që ishin të mira dhe në dobi të nxënësve tanë t' i inkorporojmë.

Nevzad Isufi- unë po lidhem me fjalën e drejtorit për Zhvillim Ekonomik, se të gjithë e dimë se hapësira e Universitetit është hapësirë e përkohshme, sepse po të mbetej Universiteti nuk duhet llogaritur në atë hapësirë afatgjate, prandaj kjo nuk do të duhej të jetë ndonjë arsyetim. Nëse e keni pasur për qëllim vetëm për formalitet të diskutohet, atëherë mos e debatoni, sepse e dimë që i keni votat. Shikoni përmbajtjen se çka është diskutuar dhe çfarë vërejtje dhe sugjerime janë dhënë?

Rexhep Kadriu –arsyeja pse i kemi bërë këto ndryshime janë dy: e para janë kërkesat e 14 mijë qytetarëve të lagjes “Dardania”. E dyta arsye është, sepse është deshtë të futet Shkolla e Muzikës në këtë rrethojë. Nëse kërkon po i elboroj në kino- projektor.

Në vijim të fjalës së tij zv/kryetari dha arsye në detale për revidim të këtij projekti me anë të kino-projektorit.

Riad Rashiti- po më vjen keq që po e them “a e dini ju” se kjo ndërhyrje, ky revidim të tërë projektin e kthen në fazën zero. Nuk ka logjikë një projekt në të cilin është punuar dy vite të kthehet në pikën zero, sepse kjo është miratuar kështu si është nga Ministria e Financave. Nëse tash bëhet ndërhyrje, atëherë i tërë procesi kthehet në fazën zero.

Unë mendoj se Drejtoria e Urbanizmit dhe ajo Zhvillimit ekonomik për ta bërë këtë “revidim” ta propozoj në Kuvend anulimin e projektit të kaluar dhe atëherë është në rregull.

Anuloni vendimin paraprak, sepse ende është në fuqi i pari dhe aprovone këtë që po e paraqitni do të jetë më ligjore dhe më e kapshme.

Izmi Zeka- na kaluan disa orë dhe po flasim për një pikë të rendit të punës, por më mirë rikthehe në pikën zero, sepse po thoni herë është interes i qytetarëve herë i Komunës. Kërkesa nuk ka nga qytetarët dhe nëse ka, unë sot e dërgoj listën, por edhe nëse e paragjykoni se është interes i qytetarëve është paragjykim. Del dikush thotë unë jam arkitekt e di më mirë etj.

Mua më habit një fakt këta ekspertë kanë qenë edhe kur është aprovuar në mandatin e kaluar ky projekt, këta inxhinier dhe projekti ka qenë i mirë, kurse sot bëjmë ndryshim.

Kush e bënë këtë ndryshim përsëri këta ekspertë!?

Projektet bëhen për interes të qytetarëve dhe jo pse dëshiron një kryetar apo drejtor.

Ne dimë se çka është revidimi, sa është e drejta revidimit, por po i nxirrni punë vetes pa nevojë. Analizoni gjërat se çka keni bërë, ia keni dhënë vizën, kurse tash ai zyrtari i Urbanizmit thotë diçka tjetër. Unë e di që i keni votat dhe do ta votoni, por shikoni në afat të gjatë projektin e kompleksit të shkollave të mesme dhe jo interesin aktual. Për mua një shtëpi edhe pse rrënohet fare nuk brengosem, por me rëndësi ia kompleks të jetë i qëndrueshëm për një kohë të gjatë.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja kërkon që anëtarët e KK-së ta aprovojnë pikën 2.2 të rendit të punës.

Aprovohet pika 2.2 e rendit të punës: Propozim vendimi mbi qasjen e revidimit të vendimit për miratimin e zgjidhjes urbanistike të kompleksit, Shkollat e Mesme në Gjilan, me 20 vota të anëtarëve të KK-së, 10 ishin kundër, kurse të tjerat abstenime.

2.3- Propozim-vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm “Lagja e spitalit” në Gjilan

Valentinë Bunjku Rexhepi- propozimi i shefit të grupit të LDK-së ka qenë që pika 2.3, 2.4 dhe 2.5 të debatohen si një pikë dhe të votohen në pako, pasi që kanë ngjashmëri në mes vete. Për këtë arsye e lus zyrtarin e Urbanizmit që të na ep sqarime për këto tri pikë., kurse pas sqarimeve i propozojmë për aprovim.

Mumin Kçiku- të tri hapësirat, të tri vendimet për shkak të përkufizimit për shkak të interferimit të objekteve të infrastrukturës dhe limiteve tjera dhe si lokacione ne kemi shkuar me përkufizim dhe ndarje, sepse edhe ato pjesë duhet të përfshihen në planifikim hapësinor në bazë të udhëzimeve administrative për hartimin e planit.

Megjithatë hartimi dhe baza juridike të të gjitha vendimet përafërsisht është i natyrës së njëjtë ngase jemi në fazën e revidimit të planeve të të gjitha planeve nga periudhat e kaluara. Disa pjesë si p.sh te Lagja e Spitalit planin e fundit detal urbanistik e ka që nga viti 1984 i cili nuk është realizuar sipas atij procesi që ka qenë i planifikuar. Pjesa tjetër e Zabelit më herët është marrë një vendim vetëm për një sipërfaqe prej 25 hektarësh nga një pjesë e cila nuk ka pasur plan rregullues urban. Mirëpo në ndërkohë pasi që ka hyrë në fuqi Ligji për obligim hapësinor dhe ka obliguar që t’i qasemi harmonizimeve me këtë ligj ne kemi shkuar në rritjen e sipërfaqes dhe tash kjo sipërfaqe tash është afër 85

hektarë. Një pjesë ka plan detaj urbanistik, një pjesë nga viti 1984, kurse një pjesë e konsiderueshme nuk ka fare plan detaj urbanistik.

Pjesa “Qendra 3” edhe kjo është një pjesë edhe këtu ka plane diku nga viti 1973 dhe 1976, por ndonjë plan konkret i cili është i periudhave më të reja.

Sa për informim vitin e kaluar kemi përfunduar me revidime të pjesës më të madhe të planeve, kurse tash na kanë mbetur edhe këto tri pjesë dhe pas këtyre mbetet vetëm lagjja “Dardania” e cila deri diku në të gjitha pjesët që ka pasur plane është realizuar përafërsisht në parashikime të duhura.

Bajram Hasani- do të thotë se këto tri pikë ndryshojnë nga pika 2.2, sepse atë e quajtmë revidim, kurse në këto tri pikë të tjera kemi hartim të planit të cilin e elaboroj zyrtari i Urbanizmit i cili planifikim nuk është bërë një kohë të gjatë. Unë te këto tri pikë pasi që nuk ka pasur plan rregullues, duhet patjetër t’i hapet qasja. Mirëpo e kam një pyetje për zyrtarin e urbanizmit: kur hapet procesi i revidimit, për hartimin e një projekti ose revidim sido që të quhet, a ngrihet ky proces apo mundet gjatë kësaj periudhe deri në vendim tjetër deri në hartim të lejohen leje të ndërtimit?

Mumin Kçiku- në asnjë vendim ose në asnjë dispozitë ligjore nuk është e paraparë, sepse vendimi për qasje të hartimit të një plani të hollësishëm nuk ndalon realizimin nga që konsiderohet vendimi për qasje vetëm të hap rrugë për zhvillimin e debateve, për marrjen e interesave dhe harmonizimin e atyre interesave në trendet dhe zhvillimet më të reja për pa e cenuar planin ekzistues deri në miratim. Me rastin e miratimit pas kalimit të të gjitha fazave të debateve publike të projektit final dhe miratimit nga Kuvendi, atëherë ky plan mbetet jashtë fuqisë. Deri në aprovim vlen plani ekzistues.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja i propozon anëtarëve të kuvendit që ta aprovojnë pikën 2.3, 2.4 dhe 2.5 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2.3, 2.4 dhe 2.5 e rendit të punës; **2.3-** Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm: “Lagja e Spitalit”, në Gjilan

2.4 Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm: “Qendra -3”, në Gjilan dhe **2.5** Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm: “Zabeli-1”, në Gjilan, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, 10 ishin kundër, kurse të tjerët abstenuan.

Sahit Abazi – po vërehet se ne po abstenojmë gjatë votimit shumë herë edhe pse dhe abstenimi është mënyrë e votimit, por arsyeja e jonë është kjo që në shumicën e herëve, pavarësisht sa diskutime tona janë përmbajtjesore, pavarësisht sa profesionale janë asnjëherë nuk merren parasysh dhe gjithmonë kalohet ajo që është planifikuar dhe realisht Kuvendi përdoret vetëm për votim. Asnjëherë nuk kemi pasur rast ku pas diskutimeve të gjata të merret parasysh ndonjë qëndrim apo vërejtje e opozitës.

Ne e kuptojmë që ju i keni numrat, por kur ka ndonjë diskutim profesional që e vlen ose merrni parasysh ose vetëm i hidhni në votim dhe nuk ka nevojë për debat! Ju lus të keni konsideratë për opozitën ose kur të fillojë seanca i hidhni në votim dhe e përfundojmë seancën, sepse nuk po merren parasysh kërkesat tona. Këtu e kam fjalën për drejtorët e drejtorive të cilët janë sponsor të revidimeve dhe çdo pikë e rendit të punës që vije këtu! Ka qenë në pushtetin monist një pushtetar i cili në mbledhje të rëndësishme e thoshte a e përfundojmë për pa e filluar sepse nuk ka nevojë për diskutime. Unë uroj që KK të mos bie në atë nivel!?

Valentinë Bunjkau –Rexhepi- pasi që na u drejtove neve, unë po theksoj se opozita ka të drejtë dhe ka hapësirë shumë të mjaftueshme për propozimet e juaja, mirëpo a merren parasysh apo nuk merren varet se çka janë ato propozime? Varet se a bazoheni diku dhe a keni argumente për ato propozime. Pyetjet e anëtarëve të PDKs-së të cilët po i bëjnë është mirë që t’i drejtohen me shkrim kryetarit, kurse kryetari do të jap përgjigje me shkrim ose në seancë të radhës do të jetë prezent. Pas debatit të gjitha pikave nëse dikush ka ndonjë vërejtje ose propozim për ndryshme urdhëroni.

3. Të ndryshme

Arben Maliqi- ne nganjëherë bëjmë kritika, por në përgjithësi drejtorët e bëjnë një punë të mirë, duke filluar nga Shërbimet Publike, sepse rrugët janë të harruara dhe ajo që më ka lënë përshtypje të mirë është ajo që nuk ka pasur dallime. Sa i përket lagjes sime gjithkund është punuar njëjtë dhe në asnjë vend nuk ka dallime sipas partive ose nacionaliteteve. Administrata po e bën në punë të mirë, sepse nuk ka pasur probleme në sportele në kohën kur bashkatdhetarët tanë ishin në pushime. Gjithashtu edhe Drejtoria e Inspeksionit po e bën një punë të mirë, sepse në ora 11 po ndalet zhurma nëpër kafiteri dhe restorante dhe kur bëhen punë të mira duhet thënë publikisht.

Ismet Hajdini – unë po e përcjell një pakënaqësi të qytetarëve dhe të bizneseve në “Dardani” përballë shkollës “Selami Hallaçi” në të cilin vend ka filluar inkasimi i mjeteve për parking të veturave. Unë personalisht mendoj se është shumë e padrejtë, sepse nuk mund të krahasohet parkingu para shtëpive private me parkingun që është në qendër të qytetit i cili nuk i pengon shtëpitë private. Të gjitha ato shtëpi kanë leje të ndërtimit dhe me leje të ndërtimit kuptohet se qytetari ka qasje dhe duhet të ketë infrastrukturë. Nëse para shtëpisë së qytetarit ose para bizneseve inkasohen mjete, mendoj se nuk është e drejtë, prandaj është një reagim i qytetarëve të cilët janë duke mbledhur edhe nënshkrime. Mendoj se duhet të rishikohet ai parking përballë Shkollës “Selami Hallaçi”, sepse ato janë shtëpi private, prandaj edhe dëmtohen edhe banorët, por edhe bizneset.

Fehmi Sylejmani- nën të ndryshme është mirë të mos bëhen komente, por të bëhen pyetje të drejtpërdrejta dhe nuk kemi nevojë të komentojmë dhe t’i japim askujt leksione ose ligjërata. Unë i kam dy pyetje: për drejtorin e Shërbimeve Publike ose për atë për Zhvillim Ekonomik për të cilin rast ka qenë desh të flet parafolësi, sepse në rrugën tij që nga muaji i dytë ka filluar asfaltimi i rrugës, por ende nuk ka përfunduar. Pse zvarritet puna në këtë rrugë dhe pse nuk përfundon puna? Mandej e kemi edhe rrugën e XII në “Dardaninë I” dhe tash ka filluar rruga e IX dhe do të thotë janë duke shkuar procedurat shumë të ngadalësuara.

Pyetje tjetër është për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; cilat klube sportive deri më tash janë ndihmuar, me çfarë mjete i keni ndihmuar dhe në cilat faza iu është dhënë ajo ndihmë dhe me çfarë formule iu keni ndarë mjete atyre klubeve?

Arijetë Rexhepi- po e parashtroj një pyetje e cila i përket Drejtorisë së Urbanizmit: pyetja ka të bëjë me çështje të ndërtimit e cila po ndodh në oborret e “Sillostit”. E dimë se kjo fabrikë është shitur me spinof special, por një pjesë e sajë është shitur nga pronari ku ka filluar të bëhet një ndërtim komercial. Sillosi është me rëndësi për qytetin tonë dhe është një rezervar i ushqimit për tërë qytetin, prandaj sa është e logjikshme dhe e drejtë të ndërtohet një objekt afër kësaj fabrike e cila prodhon bukë? Çfarë leje urbanizmi ka

dhënë për këtë objekt dhe sa është e arsyeshme kjo leje?

Sadullah Kadriu- unë e kam një pyetje nga qytetarët e lagjes “Dheu i Bardhë”, konkretisht rrugës “Vëllezërit Frashëri”, sepse aty është shembur një mur dhe dot ë duhej dikush të ndërmerret diçka urgjentisht, sepse mund të shfaqet ndonjë e epidemi, sepse ka qen të ngordhur dhe përhapja e mushkonjave është në sasi të madhe!

Ai mur duhet të pastrohet apo ndërtohet. Një tjetër dukuri e cila po shfaqet në Kuvend është se të gjithë anëtarët po i mbrojnë vetëm interesat e lagjes së vetë, kjo ndoshta është normale deri diku. Mirëpo në lagjen “Dardania I” është lagja më emirë dhe me infrastrukturë të mirë, por është rruga “Rukije Haliti” e cila e lidh rrugën qarkore dhe është hyrje dhe dalje dhe nuk mund të merret me mend sa baltë del nga ajo rrugë në të dy anët. Kjo rrugë ka mbetur e shkretë, por në këtë gjendje është edhe një tjetër e cila nuk di si quhet, por edhe lagja te fermtat gjendet në mjerim. Prandaj do të ishte mirë që kur të investohet të kemi kujdes dhe lagjen “Dardania” ta bëjmë parajsë, kurse diku tjetër të jetë ferr.

Jashar Jashari – përkushtimi i kryetarit të Komunës, z. Haziri për realizmin e projekteve tani po bëhet realitet. Këtë po e them se banorët e fshatit Bilinicë për Festën e Bajramit patën festë të dyfishtë, sepse u bë asfaltimi i rrugës prej Pogragjës deri në këtë fshat.

Ky ka qenë një lokalitet gati i harruar, por kryetari Haziri e mbajti fjalën dhe shpresat e këtyre banorëve të fshatit Bilinicë për një jetë më të mirë janë shtuar. Kjo është një e arritur madhore për fshatrat e brezit kufitar, sepse atyre u mundësohet një jetë më e mirë dhe po parandalohet shpërngulja e banorëve të brezit kufitar.

Të vetëdijshëm se kemi trashëguar një borxh shumë të madh nga qeverisja e kaluar, kështu mundësit e asfaltimit të rrugës Pogragjë- Gjilan, për këtë vit janë minimale, por qytetarët e Pogragjës kërkojnë që së paku të bëhet mbushja e gropave në këtë aks rrugor si dhe rregullimi mureve i mbrojtëse, sepse kjo rrugë ka kthesa të ndryshme.

Ndonëse ishte “prioritet” i qeverisë së kaluar asfaltimi i rrugës “Agush Haziri”, dhe “Motrat Qiriazit” e cila nuk ka më shumë se 700 metra, kjo nuk ndodhi edhe pse banorët e kësaj lagjeje janë parapagues të rregullt ndaj obligimeve komunale. Rruga nuk u asfaltua edhe pse kryetari i Komunës dhe Zyra e Projekteve na mbajtën gjatë me premtime për 6 vite të qeverisjes së tyre. Unë po i përcjelli shqetësimet e lagjes, sepse u bën shumë vite dhe asgjë nuk u investua në këtë lagje. Banorët e kësaj lagjeje me vetë investim i kanë blerë shtyllat elektrike dhe në hapjen e kanalizimit për ujërat e zeza.

Mendoj se duhet t’epet prioritet ndriçimit dhe asfaltimit të asaj rruge, sepse jam bindur se një rrugë të tillë kaq të degraduar dhe të paasfaltuar nuk e gjen askund në qytet.

Tash kjo rrugë është në prioritet dhe punimet veç kanë filluar dhe premtimet e kryetarit Haziri veç po bëhen realitet.

Nevzad Isufi- kam pyetje, por njëkohësisht edhe vërejtje përkitazi me ankandin publik të dhënë në shfrytëzim të pronave të Komunës. Këtu është fjala për parkingun i cili është dhënë në bazë të ankandit, vërejtja është se ky ankand është shpallur vetëm në faqen zyrtare të Komunës, por nuk jemi informuar në mënyrë të mjaftueshme në mjete të tjera të informimit. Qytetarët nuk kanë pasur informata të mjaftueshme për këtë dhe qyfterëve nuk iu është mundësuar pjesëmarrja e konkurrimit, por edhe Komuna e ka humbur mundësinë e pasjes së ofertave më të mira se këto që i ka pasur.

Një vërejtje tjetër është se pjesëmarrja e komisionit ka qenë jo e plotë, kryesisht me anëtarë vetëm të pozitës dhe pa asnjë të opozitës. Unë pyes pse mos ta kemi edhe ne përfaqësuesin tonë në këtë komision.

Mandej po flitet për ta dhënë në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, në këtë rast parkingut dhe nuk përmendet askund afati as me muaj dhe as me vit. Unë kam pyetje sa është ky afat i shkurtës të cilin e thoni ju?

Mendje në këtë ankand për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, Komuna ka mbajtur në punë në mënyrë të paligjshme punëtorë ilegal, pa kontratë dhe disa prej tyre kanë punuar 12 vjet, kurse më së paku 6 vjet. Mirëpo këtë vit, janë larguar pa asnjë vendim dhe arsyetim. Kjo është e pashembullt, kjo është skandaloze. Komuna e cila e ka për obligim mbrojtjen e ligjshmërisë bënë shkelje të tilla duke mos respektuar ligjin e punës për vite të tëra. Dikush këtu duhet të jetë përgjegjës për këto shkelje të rënda, sepse këtu kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave themelore të njeriut. Këtyre njerëzve pas kaq viteve të punës nuk iu duhet t' i shkel dikush të drejtat, por duhet gjetur zgjidhje në dobi të tyre. Mbajtja në punë e këtyre njerëzve ka qenë deshtë të jetë kusht edhe me fituesin e këtij ankandi. Pasojat kanë lindur me ankandin posa e keni mbyll!

Bajram Hasani-unë po ndërlihem me anëtarin e Vetëvendosjes lidhur me Sillosin dhe po e potencoj se ajo ndërmarrje nuk është shit me spinof special dhe duhet bërë dallime. Nëse nuk është me spinof special pronari mund ta ndërron destinimin dhe nuk është i obliguar që të vazhdojë me atë veprimtari. Është interes i Komunës dhe mua më duhet për ta shfaq interesin dhe të shpallet interes për të mbetur ajo pronë.

Mirëpo sa i përket lejes së ndërtimit, a ka plan dhe leje, duhet drejtoritë përkatëse të merrem me këtë çështje. Ajo është e trajtuar si zonë industriale dhe a lejohet ndërtimi apo jo duhet ta verifikojnë drejtoritë përkatëse. Sa i përket pronarit ka të drejtë për ta ndërruar destinacionin, sepse nuk ka kusht nga privatizimi, sepse nuk është blerë me spinof special, por në mënyrë të rregullt.

Riad Rashti- unë fillimisht mbështes propozimin e grupit të këshilltarëve të LDK-së që kërkesat drejtuar kryetarit të Komunës të bëhen me shkrim, për shkak të mos humbjes shumë kohë në seancë, por dhe për shkak të komunikimit të drejtpërdrejt. Mirëpo këtu është një problem shumë serioz të cilin qysh në fillim të seancës e ngrita e që ka të bëjë me mos përgjigjen e kërkesave të cilat ne ia kemi drejtuar. Unë e thash se i kam drejtuar 8 kërkesa kryetarit të Komunës që nga data 19 prill të këtij viti dhe asnjë përgjigje nuk e kam marrë. Si po e sheh grupi i LDK-së zgjidhjen e këtij problemi? Edhe kryesuesja e KK-së i ka pranuar 6 kërkesa të drejtuara nga unë dhe asnjë përgjigje nuk e keni dhënë! Kam pyetje kryesuese, pse së paku ju nuk jeni përgjigj në 6 kërkesat e mia të cila t' i kam bërë me shkrim? Definitivisht mos përgjigja në kërkesa do të thotë diçka, ose nuk dini të përgjigjeni ose nuk dëshironi/ Në fillim të seancës i theksova tri kërkesa; një kërkesë kryetarit të Komunës dhe ai iku prapë si zakonisht dhe lus sekretarinë që ta bëjë me shkrim përgjigjen e cila ka të bëjë me lirim të menjëhershëm të hapësirave publike, sepse me këtë rast janë bërë tri shkelje ligjore e të cila ti përmendi përfaqësuesi i LVV-së. Mirëpo në këtë rast është shkel edhe Ligji për shfrytëzim të pronës publike, është shkel Ligji i prokurimit. Operatori ekonomik sot e 10 ditë ka filluar ta implemtojë një kontratë të panëshkruar. Inkasohen mjete në mënyrë të paligjshme, kjo është një shkelje e rëndë, po vazhdoni me shkelje të rënda, po vazhdoni me shkelje ligjore dhe nuk ka transparencë. Ju e keni shumë të qartë ajo çka thuhet me ligj. Në momentin që shpallet tender është e obligueshme që autoriteti kontraktues ta bëjë një shpallje në portalin e KRPP-së, por asnjë shpallje nuk e keni bërë zyrtarisht. Të gjitha informacionet që i kemi marrë i kemi marrë në mënyra tjera, por jo në mënyrë institucionale! Ne jemi në terr informativ, por kam edhe një pyetje se a ka të punësuar në KK- të Gjilanit që

paguhen privatisht, unë e bëra këtë pyetje dhe e pres edhe një përgjigje. Ka njerëz në Komunë të Gjilanit që punojnë dhe kanë qasje në pasurinë e Komunës së Gjilanit dhe të cilët nuk kanë të drejtë të punojnë dhe paguhen privatisht!

Komuna Gjilanit nuk është kompani private dhe nuk mund të merren shoferë dhe asistentë dhe të paguhen privat. Kuptoni kjo është e kundërligjshme, kjo është shkelje e rëndë, keni marrë punëtorë dhe po i siguronit objektet shkollore të Komunës dhe objektet shëndetësore. Si pranoni njerëz pa kontratë i paguani privat dhe e sigurojnë pasurinë e Komunës? Bëra pyetje a është shkel rregullorja për ndarjen e subvencioneve? Janë dy konstatime që dua përgjigje? A janë shkelur dhe pse janë shkelur këto dy rregullore për këto dy raste. Në fund e falënderoj Komunën e Gjilanit për asfaltimin e rrugës së fshatit Bilincë dhe është puna e parë e dobishme që e ka bërë!? Asnjë punë e hajrit deri më tash nuk është bërë deri më tash me përjashtim të kësaj rruge i cili projekt është tenderuar në vitin 2013. Është rregulluar ndriçimi publik në fshatin Bilinicë, është rregulluar kanalizimi, por edhe asfaltimin e kemi filluar ne, por për arsye të ndryshme është shtyrë. Mirëpo e falënderoj Komunën që punët e PDK-së që i ka filluar po ia del disi t' i kryej dhe unë iu uroj suksese. Mirëpo filloni ndonjë punë të juaj të hajrit!

Fehmi Sylejmani- unë i kam dy arsyeje pse e përmendi “Dardaninë”, sepse për këtë çështje, m’ u përmend edhe emri. Unë po e potencoj se u përmenden 14 mijë qytetarë, por unë nuk jam në mesin e 14 mijë qytetarëve që po thirret dikush.

“Dardania” i ka dy arsyeje: e para në këtë lagjeje, kanë kaluar 4 dekada dhe asgjë nuk është investuar, kurse si arsyeje e dytë është se banorët e kësaj lagjeje janë ndër më të disiplinuarit sa i përket kryerjes së obligimeve komunale në Gjilan, prandaj KK këtë lagjeje duhet ta ketë prioritet gjithmonë.

Gjithashtu kam edhe një pyetje për Drejtorin për Shëndetësi, por e cila nuk qenka në seancë pyetja i drejtohet dr. Imet i cili është edhe kryetar i Komitetit të Shëndetësisë:

A ka mundësi që të reduktohen procedurat burokratike për marrjen e insulinës?

Arijetë Rexhepi- unë këtë diskutim timin po e quaj replikë, sepse e parashtrova një pyetje për të Drejtorinë Urbanizmit për të cilën pyetje e mora një përgjigje, por thuhet se “Sillosi” nuk është shitur me spinof special. Ne e dimë se Sillosi është me rëndësi të madhe dhe është hambar i qytetit, kurse aty afër lejohen ndërtime që e rrezikojnë atë hambarë. Pyetje iu është bërë Drejtorisë së Urbanizmit dhe jo për persona të cilët kanë interesa në atë pjesë? Kërkojmë për ta ditur se çfarë leje është dhënë dhe sa e rrezikon ai objekt hambarin e qytetit?

Bujar Nevzadi- unë kërkoja që në seancën e ardhshme dhe ka kaluar një kohe e gjatë dhe nuk po mund të ballafaqohemi me kryetarin, prandaj në seancën e radhës në pikën e parë të më epet fjala, sepse sot e kërkoja nën të ndryshme, por ai përsëri nuk qëndroi deri në fund në seancë

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- kryetari ia drejtoni pyetjet me shkrim dhe ai iu përgjigjet, por nëse është në seancë mund të përgjigjet menjëherë.

Nevzad Rushiti- unë po i përgjigjem kolegut nga Dheu i Bardhë se në prioritet për këtë lagje është edhe rruga “Rukie Haliti” dhe “Vëllezërit Llozana”. Prioritet e para kanë filluar në qendër të lagjes dhe në vijimësi edhe në rrugët e tjera. Mirëpo e di saktë që në atë rrugë është investuar me vullnet të qytetarëve, por në këtë pushtet me siguri do t’ i përfundojmë edhe ato dy rrugë.

Unë do të përgjigjem edhe për Komisionin për ankande publike, por opozita nuk ka durim për të na duruar neve, sepse e kanë humbur pushtetin dhe kanë bërë gabime të mëdha dhe nuk mund të na durojnë me argumentet tona të fuqishme. Ky Kuvend e ka propozuar komisionin prej 7 anëtarëve dhe ai komision e ka filluar punën me mungesën e kandidatit të opozitës, pra të PDK-së. Kjo është injorancë e Ekzekutivit dhe të Kuvendit dhe në mënyrë jo transparente gjejnë arsyeje për ankesa. Ky komision ka punuar sipas ligjit në fuqi, por është diçka tjetër se ky ligj ka gabime apo jo, por para ligjit duhet të jemi të barabartë dhe kemi punuar me ligj. Këto parkingje, hapësira publike që nga viti 2009 me marrëveshje (mirëkuptim) iu është dhënë OVL-së, por ky mirëkuptim është keqpërdor, sepse këta ia kanë dhënë personit të tretë dhe ne si qytetarë e kemi vërejtur dhe sipas informatave askush nuk e dinë sa ka të hyra në Komunë? Për këtë arsyeje ankandi publik nuk ka qenë me qëllim të keq, por ka qenë me qëllim të mirë, sepse e drejtë ligjore është edhe e kryetarit edhe e Kuvendit që të merret me pronën e vetë. Procedura ka qenë në mënyrë ligjore, matjen e ka bërë Drejtoria e Kadastrit dhe sipas fletës posedues janë caktuar edhe m katror për shfrytëzim. Sipas tërë kësaj matje ka dale që këto 8 lokacione dalin 6600 metra katror në shfrytëzim për parkingje. Çmimi fillestar duke u bazuar në të hyra vjetore të mundshme është dhënë 4 euro për m katror. Informimi ka qenë gjithashtu jashtëzakonisht i mirë edhe nga kryetari i Komunës, por edhe në shtyp ditor, por edhe në mjete të informimit elektronik. Këtë po e argumentoj se 22 persona fizik kanë aplikuar, por ka pasur edhe aplikues edhe jashtë Komunës së Gjilanit. Kur ka ardhur koha për t' i hap ofertat kanë ardhur 8 aplikues dhe janë emrat dhe mbiemrat e posedoj tabelën zyrtare. Ndërsa ditën që e kemi bërë vizitën ne terren dhe kemi deshtë të jemi sa më transparent dhe çdo aplikues ka pasur mundësi ta shoh hapësirën dhe sa metra katror janë? Atë ditë kanë ardhur 16 persona juridik dhe fizik dhe e kanë vizituar çdo parking, kurse procesi i fundit i hapjes së ofertave është i fundit dhe i posedojmë emrat dhe mbiemrat. Unë po flas me moral dhe pa frikë, sepse nuk i kam borxh askujt, unë i kam borxh vetëm të drejtës dhe zotit dhe nuk ka asnjë lajthitje në këtë aspekt. Sa i përket punëtorëve ligji nuk e përcakton që operatori i dytë ta punësojë atë të operatorit të parë, por unë besoj se kryetari i Komunës do ta parashohë këtë çështje dhe nuk do të thotë që ai që e ka pasur këtë tender duhet t' i punësojë ata punëtorë që kanë qenë. Ne e kemi kryer punën ashtu si duhet pa asnjë vërejtje, proceset janë dhe nuk duhet dhënë kahe tjetër kësaj çështje.

Imet Rrahmani- unë në pozitën kryetarit të Komitetit për Shëndetësi do ta jap një shpjegim sipërfaqësor të problemit që e ngriti kolegu Fehmi Sylejmani. Është legjitim shqetësimi i kolegut Fehmi, sepse ne kemi biseduar edhe në biseda private dhe është një proceduar e trashëguar, burokratike e sigurimit të insulinës për grupe të rrezikuara të diabetikëve. Ekziston një qendër e diabetit e cila nuk ka funksionuar mirë në mungesë të kuadrove, sepse ekziston vetëm një doktore, por aty ka edhe probleme të tjera organizative. Insulina sigurohet nga Qeveria dhe për fat të mirë këtë vit nuk kemi mungesë të insulinës ashtu si ka ndodhur vitin e kaluar. Me drejtorin e QKMF-së e kemi trajtuar këtë çështje, por ende nuk kemi arrit për ta trajtuar në Komitetin për Shëndetësi. Mirëpo në mbledhjen e ardhshme e cila do të mbahet në shtator do ta shqyrtojmë këtë problematikë, por edhe QKMF-ja është në fazën e riorganizimit. Po e theksoj se nga Ministria e Shëndetësisë është nënshkruar Statuti për QKMF i cili duhet të kalojë në debat publik dhe në procedura tjera të komitetit dhe Kuvendit. Me këtë do të bëhet komplet riorganizimi i strukturës menagjuese, por edhe i njësive funksionale të kujdesit primar shëndetësor dhe do të kemi një organizim më të mirë të shpërndarjes së insulinës dhe produkteve tjera shëndetësore. Po iu njoftoj se deri më tash i kemi mbajtur 6-7

mbledhje të Komitetit për Shëndetësi dhe ky komitet është një ndër më aktivët në KK të Gjilanit. Gjithashtu po iu njoftoj se i kam edhe 6 kërkesa të cilat ia kam drejtuar Drejtorisë për Shërbime Publike të cilën e falënderoj publikisht, sepse aq sa ka pasur mundësi kërkesave të qytetarëve të cilat ia kam drejtuar iu ka përgjigjur dhe janë realizuar të gjitha projektet për të cilat kemi bërë kërkesë. Gjithashtu kemi bërë kërkesë edhe për lagjen e Vishnjes për kanalizim. Sepse atje është një gjendje e rëndë, sepse duke i "falënderuar punës së madhe" që ka pas bërë qeveria e kaluar me lidhjen e kanalizimit të shkollës në kanalizimin privat "F- 100". Mund ta vërtetoni se në sa puseta del kanalizimi në këtë rrugë? Është projekti për trajtim të ujërave të zeza në atë lagje, asfaltimin e rrugëve dhe për definim të rrugëve, sepse atje ka edhe probleme pronësore. Ka edhe kërkesa të tjera, por ne do t' i shqyrtojmë të gjitha kërkesat e qytetarëve pa dallim partie dhe dallime të tjera.

Nevzad Isufi- lidhur me arsyetimet që i dha kolegu im Nevzadi disa vërejtje nuk u arsyetuan, sepse pa opozitën e keni formuar këtë komision. Tjetër me gjithë afatin ligjor, megjithatë nuk ka qenë e paligjshme të caktohet sa është afati ligjor? Duhet të thuhet sa është afati maksimal dhe ai më i shkurtër, atëherë nënkuptohet. Tjetër nëse keni qenë pjesë e Kuvendit edhe herën tjetër dhe kanë ndodhur që thoni ju se paratë e parkingjeve publike kanë shkuar në xhepa privat dhe ju nuk keni reaguar, atëherë është gabim i juaj!? Keni lejuar që të shfrytëzohet pasuria publike për persona privat, sepse pasuria është edhe e pozitës dhe opozitës. Gjithashtu edhe ata njerëz të cilët kanë punuar për 12 vite, duhet marrë parasysh, sepse edhe ata janë qytetarë të Gjilanit. Unë mendoj se deri më tash është bërë gabim, duhet përmirësuar atë gabim, por u tha edhe nga kolegët se edhe njerëzit të cilët nuk janë më, kontratat nuk janë nënshkruar, por njerëzit po bëjnë punë. Kjo është mënyrë joligjore, pa kontratë. Qytetarët janë në presion sa herë të hyjnë dhe të dalin me veturë para shtëpisë së tyre.

Valentina Bunjaku –Rexhepi- iu falënderoj z. Isufi, por ju në këtë Kuvend keni deklaruar se nëse PDK nuk hyn në këto komisione edhe ne tërhiqemi. Ne iu kemi lutur që të merrni pjesë në këto komisione, por ju nuk keni pranuar të jenë pjesëmarrës të komisioneve.

Sokol Haziri- unë do të bëjë kallëzim penal për z. Riadin e të cilat kallëzime janë bërë modë lidhje dhe pa lidhje, sepse nuk më ka pritur për të dhënë përgjigje. Ja ku e kam shkresën dhe iu kam përgjigj Riadit në çështjen të cilën e ka parashtruar. Unë kërkoj nga ju që në takimin e ardhshëm të Kuvendit ma jepni fjalën në pikën e parë dhe t' i përgjigjem, sepse nuk është e vërtetë dhe nuk qëndron ajo që Komuna nuk është transparente, drejtoritë jo transparente dhe unë e kam dëshminë se më 18 e kam marrë kërkesën e tyre, kurse më 23 përgjigja është dorëzuar në zyrë të PDK-së. Është shumë jo korrekte të thuhet të pavërteta në Kuvend. E dyta sa i përket parkingjeve u përgjigj Nevzadi dhe ka qenë një konferencë për shtyp në Zyrën e Kryetarit. Mirëpo një fjali do ta them që nuk është e vërtetë që janë inkasuar mjete për këta muaj që ka pasur ankesa. Ka qenë një keqkuptim, ne kemi udhëzuar për të dal për t' i parë vendet dhe ta fillojmë një parapërgatitje për ta njoftuar opinionin paraprakisht. Si janë zbatuar dhe respektuar procedurat u tha, prandaj unë kërkoj nga sekretaria që të gjithë 35 anëtarëve të Kuvendit t' i bëhet nga një kopje të tërë procedurës si ka rrjedh. Unë i kam shënimet dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike do të përgatitet një informacion dhe çdo anëtarë i Kuvendit do ta ketë të qartë si ka lëvizur ky proces. U thanë shumë shqetësime të lagjeve të qyteti, por po e them shumë sinqerisht se është duke u punuar në të gjitha

lagjet e qytetit për pa bërë dallime se kush cilës parti i takon, sepse nuk tërhiqemi nga ato parime dhe parim e kemi se të gjithë qytetarët e Kosovës janë tanët. Unë i ftoj anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë qyfterët që për çështje të shërbimeve publike të vijnë në zyrën time, sepse ajo është e hapur në çdo kohë të ditëve të punës dhe së bashku i adresojmë çështjet bashkë aq sa kemi mundësi.

Ismet Hajdini- te parkingjet, unë personalisht jo njëherë, por disa herë kam paguar tatim (në qendër afër Komunës). Nuk e kam të qartë a ka filluar inkasimi, apo dikush ilegalisht po inkason mjete!? Unë kam paguar disa herë dhe jo njëherë!?

Ibish Ibishi- unë e kam përgatitur një material për t' i bërë pyetje drejtorëve, por po e shoh se 70% të drejtorëve nuk janë në seancë dhe propozoj që këto pyetje të parashtrihen në fillim të seancës.

Pyetje konkrete kam për drejtorin e Shërbimeve Publike, sepse u cek se në të gjitha lagjet e qytetit po punohet. Po pyes se fshataret a janë banorë dhe kontribuues të kësaj Komune dhe kur do të fillojnë investimet edhe nëpër fshatra nga pak, sepse jam i vetëdijshëm se shumë nuk ka mundësi!?

Nevzad Rushiti- është paraparë që në çdo vend parking të ketë vend edhe për njerëzit me aftësi të kufizuara (nevoja të veçanta). Jemi të obliguar t' i njoftojmë se do ta kenë vendin e tyre, por edhe atë pa pagesë.

Me këto debate dhe vendime seanca i përfundoi punimet në ora 14.30 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë BUNJAKU- REXHEPI